

UNIVERSITETI I EVROPËS
JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА
ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITU



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**CËNIMI I SË DREJTËS ZGJEDHORE SI VEPËR PENALE NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SË VERIUT NË PERIUdhËN 2015-2021**

KANDIDAT:

Mirisha Bajrami Partallko

MENTOR:

Prof.dr.sc.Besa Arifi

Tetovë 2023

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	7
1. Lënda e hulumtimit.....	7
2. Qëllimet e hulumtimit.....	8
3. Hipotezat.....	9
4. Metodologjia e hulumtimit.....	10
5. Rëndësia e punimit	11
KAPITULLI I PARË.....	12
1. Njohuritë e përgjithshme për veprat penale kundër zgjedhjeve.....	12
1.1 Nocioni, llojet dhe karakteristikat e veprave penale kundër zgjedhjeve.....	12
1.2 Llojet e veprave penale kundër zgjedhjeve	14
1.3 Karakteristikat e veprave penale kundër zgjedhjeve	14
KAPITULLI I DYTË.....	17
2. Zgjedhjet, sistemi zgjedhor dhe llojet e sistemit zgjedhor	17
2.1 Vështrim historik i zgjedhjeve në të kaluarën në Republikën e Maqedonisë së Veriut	17
Zgjedhjet parlamentare	21
Zgjedhjet presidenciale	23
Zgjedhjet komunale	24
Referendum	26
2.2. Mashtrimet zgjedhore dhe korrupsioni gjatë zgjedhjeve dhe votimit	27
2.3. Modelet zgjedhore sot dhe ndër vite në RMV.....	29
2.3.1 Llojet e zgjedhjeve	32
Zgjedhjet dhe sistemi zgjedhor	32
Zgjedhje Parlamentare.....	32
Zgjedhje Presidenciale	32
Zgjedhje Lokale	33
2.3.3 Evidencat statistikore të marra nga organet qeveritare dhe joqeveritare gjatë zgjedhjeve	33
KSHZ-ja (Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve)	33
KKZ-ja (Komisioni Komunal i Zgjedhjeve).....	35
Këshilli Zgjedhor	35

OSBE (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë)	36
MOST (organizatë qytetare).....	37
CIVIL –AXIOS 2017 Shkup.....	37
Evidenca statistikore	38
KAPITULLI I TRETË	43
3. RAPORTI MES KRYERËSIT DHE VEPRA PENALE	43
3.1 PARANDALIMI	44
3.2. Profili i kryerësit dhe të veprave penale	46
3.3 Organet në të cilat kryhen vepra penale, keqpëdorimi i pozitës dhe autorizimi zyrtar.	47
3.4 Subjektet pjesmarrës në kryerjen e këtyre veprave penale	48
KAPITULLI I KATËR	49
4. DËNIMET, SANKSIONET SIPAS KODIT PENAL	49
4.1.Dënimet që u shqiptohen kryerësve të veprave penale për vitet 2015-2021.....	49
4.2. Disa raste të veprave penale dhe dënimet e shqiptuara kryerësve të këtyre veprave penale të viteve 2015-2021	50
4.3. Keqpëdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve	52
4.3.1 Mashtrimi.....	52
4.3.2 Dhenia/Marrja rryshfet.....	53
4.3.3 Përdorimi i dhunës dhe kërcënimeve	54
4.3.4 Mosraportimi ose raportimi i rreme i informacioneve zyrtare.....	54
4.3.5 Mjetet për zbatimin e zgjedhjeve	55
4.4 Sanksionet me të cilat janë dënuar kryesit e veprave penale gjatë viteve 2015-2021.....	56
PËRFUNDIM	62
BIBLIOGRAFIA.....	64

DEKLARATË

Unë, Mirisha Partallko, deklaroj dhe vërtetoj se jam autori origjinal i këtij punimi të magjistraturës me titull *”Cënimi i së drejtës zgjedhore si vepër penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2015-2021”*, dhe se të gjitha referencat dhe citimet të marra nga burimet e ndryshme materiale apo elektronike janë të shënuara me fusnota në fund të çdo faqe si dhe në fund të këtij punimi.

Unë deklaroj se Universitetit ia bart të gjitha të drejtat autoriale të këtij punimi për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese.

Mirisha Partallko, ID 120447

Lektoroi:

Doc.dr.Luljeta Adili-Çeliku

FALENDERIM

Rrugëtimi im në realizimin e këtij punimi, i cili ishte dhe mbetet një ndër qëllimet dhe synimet e mia më të mëdha në jetën time, ka qënë teje i gjatë dhe me shumë pengesa.

Faleminderimi më i madh i përket Allahut xh.sh i cili më hapi rrugën për realizimin e këtij qëllimi në jetë duke më dhënë besim dhe durim në arritjen e përfunditmit të tij.

Një faleminderim i madh i takon mentores sime, prof.dr. Besa Arifi për bashkpunimin dhe mbështetjen gjatë hulumtimit të punimit, këshillat dhe udhëzimet në çdo faqe të punimit hulumtues.

M'u desh shumë kohë që ta nis ta shkruaj punimin, por prindërit e mi nuk e humbën durimin për të më përkrahur e këshilluar që rrugëtimi im mos mbesi në gjysmë. Fjalët e mamit dhe babit qënë ato që më kanë frymëzuar edhe kësaj radhe për t'i dalë në fund punës së nisur.

Faleminderoj me gjithë zemër dhe do t'i jem çdoherë mirënjohëse babait tim, Nuri Bajramit, i cili më mundësoj shkollimin në këtë Universitet, gjithashtu e faleminderoj që nuk e humbi besimin se një ditë vajza e tij do të marrë titullin master, titull që të dy e ëndërronim.

Një faleminderim shkon edhe për bashkëshortin tim Adem Partallko dhe familjen tonë të cilët më mbështetën në rrugëtimin tim si dhe që ndihmuan në mbajtjen e vajzës sime Irem gjatë kohës që unë po shkruaja këtë punim. Mbështetja e tyre dhe fjalët motivuese ishin ato që më çuan deri te fundi i këtij rrugëtimi të shumëdëshiruar. Faleminderoj të gjithë ato që kontribuan në përfundimin e këtij studimi, kolegë, profesorë dhe familjarë..

Faleminderit.

HYRJE

1. Lënda e hulumtimit

Lëndë e hulumtimit në këtë punim masteri do të jenë, veprat penale të kryera gjatë procesit zgjedhor në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2015-2021, një vështrim të përgjithshëm për nocionin “zgjedhje”, procedurën dhe realizimin e tyre. Mekanizmi i transformimit të pushtetit shoqëror në pushtetin legjitim politik është i gjatë dhe ndërthurur në vete shumë aspekte ku si më të rëndësishëm mund të jetë e drejta e barabart dhe demokratike e subjekteve.

Në vijim të këtij punimi do të shqyrtojmë zgjedhjet në një shtet demokratik siç është Republika e Maqedonisë së Veriut, mbrojtja e shprehjes së lirë, mendimit të lirë dhe të barabartë, prishja e procesit zgjedhor, shkelja e ligjit zgjedhor, dhe shumë aspekte të tjera të cilat janë të mbrojtura me ligj dhe të cituara në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mosrespektimi i procesit zgjedhor dhe kryerja e disa veprimeve në dëm të saj, na paraqesin vepra penale të kryera gjatë zgjedhjeve.

Veprat penale janë të trajtuara në Kodin Penal dhe në këtë punim masteri janë si lëndë hulumtimi për sqarimin e sjelljeve kundërligjore të ndërthurura gjatë zgjedhjeve të mbajtura në periudhën e viteve 2015-2022.

Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet demokratik, ku të gjithë shtetasit kanë të drejta të barabarta të cilat mbrohen me Kushtetut. Gjatë zgjedhjeve çdo qytetar ka të drejtën e barabart për të votuar cilindo që zgjedh ai, por duke respektuar rregullën “një njeri-një votë”. Zgjedhjet e lira dhe të barabarta janë pasqyra e një shteti demokratik me të drejta të barabarta të cilat mbrojnë lirinë e shprehjes, lirinë e të menduarit, pra mbron nga cënimi ose shkelja e asaj të drejte.

Si çdo shtet tjetër edhe tek ne, në një proces zgjedhor ka shumë shkelje të cilat në disa raste kryhen nga subjektet juridike, e disa të tjera nga persona të thjeshtë. Ndër paregullsit të cilat ndodhin gjatë procesit zgjedhor janë: prishja e procesit zgjedhor, mosruajtja e fshehtësisë së votës, cënimi i votës së lirë dhe të barabart, kërcënim, fyerja, diskriminim nacional dhe racor... dhe shumë të tjera.

Vetë analiza e kryerjes së veprave penale gjatë zgjedhjeve, proceset e zbulimit, fazat e dënimit, personat të cilët e kryejnë janë lëndë e hulumtimit të këtij punimi.

2. Qëllimet e hulumtimit

Qëllime i këtij punimi është pasqyrimi i disa veprime të marra nga njerëz të thjeshtë si dhe persona zyrtarë, të cilat bien në kundërshtim me ligjin dhe na çojnë në kryerjen e veprave penale, konkretisht veprat penale gjatë zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Analizat, statistikat, metodat dhe format e kryerjes së një vepër penale zgjedhore janë qëllimi kryesor i këtij punimi.

Në një shtet demokratik si shteti ynë, të drejtë vote ka çdo qytetar i cili ka mbushur moshën madhore dhe ka aftësi psiqike për të votuar. E drejta e votës është e garantuar me Kushtetutë dhe atë “të drejtë votimi kanë të gjithë qytetarët të cilët i kanë mbushur 18 vjet e që janë të aftë për punë”, i cili parim është i detajuar në Kodin Penal në Ligjet mbi të Drejtën e Zgjedhjeve.

Edhe pse në Kodin Penal janë të sqarura dhe të detajuar sjelljet të cilat janë të ndaluara gjatë një procesi zgjedhor prap në realitet janë të pranishme këto sjellje kundërligjore. Këto veprime vijnë nga persona të cilët kanë qëllime të ndryshme gjatë zgjedhjeve, ku ndër to janë persona ose anëtar të ndonjë partie ose persona që kanë qëllime personale.

Këto veprime të cilat bien ndesh me ligjin, konkretisht veprime të kryera gjatë zgjedhjeve, format e paraqitjes së tyre, koha e kryerjes, sanksionet që i luftojnë ato dhe sidomos përshkrimi i neneve të Kodit Penal të RMV-së të cilat i ndërthurin këto veprime. Organizimi i zgjedhjeve të ndershme demokratike e bazuar në pushtetin ligjor ndihmon në frenimin e kryerjes së veprave penale.

Disa nga qëllimet dhe arsyet të cilat më kanë shtyrë që të merem me trajtimin e kësaj teme masteri janë, se:

-Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk trajtohen mjaftushëm veprimet të cilat çojnë deri tek kryerja e veprave penale gjatë procesit zgjedhor. Për të ndihmuar sa më shumë në parandalimin e tyre dhe trajtimin të disa fenomeneve kundërligjore gjatë zgjedhjeve është e domosdoshme për të trajtuar ky fenomen.

-një sqarim i asaj se si trajtohen nga Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

-si një qëllim kryesor në këtë hulumtim është edhe studimi i rasteve të veprave penale të kryera e të evidentuara në gjykatë duke ndihmuar në grumbullimin e të dhënave statistikore të kryesëve të veprave penale

3. Hipotezat

Për t'i dhënë një sqarim më të detajuar qëllimit të këtij punimi në të cilin ndërthuren veprat penale të kryera gjatë zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së, kemi paraqit disa hipoteza:

Hipoteza e parë

Hipoteza e parë përqëndrohet tek subjekti kryesor në të gjithë procedurën e mbajtjes së zgjedhjeve prej fillimit, nga publikimit i datës e deri në shpalljen e fituesit, dhe atë tek "votuesi". Votuesi duhet të përmbahet në thënien e famshme: Një votues, një votë.

Hipoteza e dytë

Shkelja e të drejtave të çdo votuesi në një proces zgjedhor, çon në krijimin e veprave penale të cilat kryhen nga të dy subjektet si ato zyrtare edhe ato të thjeshta. Institucionet kompetente janë ato që duhet të vëndohen në levizje për parandalimin e kryerjes së këtyre veprave penale, respektivisht janë institucionet te cilat duhet të luftojnë këto veprimtari që të mos vijë deri te kryerja e veprave penale.

Hipoteza e tretë

Mosfunksionimi i ligjit ose sistemit ligjor, informimi jo i saktë i votuesit, ndalimi i realizimit të drejtës së votes, rezullton në kryerjen e veprave penale.

Llojet e veprave penale gjatë zgjedhjeve:

-pengimi i zgjedhjeve dhe votimit

-shkelja e së drejtës zgjedhore, shkelja e lirisë së përcaktimit të zgjedhësve

-keqpërdorimi i së drejtës zgjedhore, cënimi i fshehtësisë së votimit

-shkatërrimi i dokumentve zgjedhore.

4. Metodologjia e hulumtimit

Në këtë punim hulumtues aplikohet metoda historike, juridike dhe bashkohore, dhe është shfrytëzuar literaturë bashkëkohore, libra universitarë, revista shkencore, punimet profesionale, shënime nga evidencat gjyqësore. Gjithashtu, janë shfrytëzuar edhe burime tjera, si: web-faqet e ndryshme të internetit, lajmet, gazeta.

Metodat të cilat janë përdorur në këtë punim janë:

Metoda historike- Në hulumtimin e një teme ose një fenomeni të veçantë, një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet edhe të kaluarës, paraqitjes së parë të zgjedhjeve, formave të para, paraqitja e partive politike-themelimi i tyre, organizatat qeveritare dhe ato joqeveritare, evolucioni në disa forma, paraqitja e saj e ndryshme në shtetin tonë, veprimet ose sjelljet kundërligjore të kryera ndër vite, skandalet më të mëdha ose kryerja e veprës më të madhe kundërligjore ndër vite dhe si dënohet ajo me ligj.

Metoda juridike- me rëndësi për këtë punim është qasja në historinë e legjislacionit juridik për të pasur një pasqyrim më të qartë në atë se si ka ardhur deri te kryerja e veprave penale, si ka ardhur deri tek ndeshja e veprimit të një subjekti me Kodin Penal, si dhe përshkrimi i vetë kryesëve të veprave penale dhe cilat kanë qenë arsyet që kanë sjellë deri tek kjo sjellje kundërligjore.

Metoda statistikore – kjo metod ndihmon në mbledhjen, përcjelljen, grumbullimin dhe pasqyrimin e të dhënave statistikore të ndryshme lidhur me vëllimin, dinamikën, strukturën dhe karakteristikat e tjera të veprave penale kundër zgjedhjeve të mbajtura në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën e viteve 2015-2021.

5. Rëndësia e punimit

Pasqyrimi i veprave penale të kryera gjatë zgjedhjeve, arritja deri tek ato vepra penale dhe në fund sanksionimi dhe dënimi me ligj i përfshirë në Kodin Penal të atyre vepra penale në periudhën e viteve 2015-2021 është vetë rëndësia e këtij punimi.

Të dhënat statistikore të grumbulluara, sidomos në periudhën e viteve 2015-2021 pasqyron edhe rrjedhojën e zgjedhjeve të mbajtura në këtë periudhë. Në këtë punimi trajtojmë zgjedhjet presidenciale, komunale si dhe zgjedhjet parlamentare. Gjithashtu, trajtohen referendimet e mbajtur në këtë shtet të cilat sollën pasoja të mëdha që deri diku ndihmuan edhe në zhvillimin e shtetit demokratik.

Statistikat e ndryshme të cilat bazohen në format e kryerjes së veprave penale, moshë, gjinia, raca si dhe përkatisa etnike jep një pasqyrim dhe një tabelë të kryerësve të veprave penale. Sanksionet të cilat u shqiptohen po këtyre veprimeve dhe mosveprimeve janë të analizuar në punim. Vetë e drejta e votës së lirë na pasqyron edhe fundamentin e një shteti demokratik, prandaj momenti i cënimit të kësaj të drejte vendos në lëvizje instrumentet e tjera shtetërore, si: gjykatën, policinë dhe dënimet e përfshira në Kodin Penal, gjegjësisht në Kodin Zgjedhor.

Në kryerjen e veprës penale ndikim të madh kanë edhe shkaqet që të çojnë në kryerjen e këtyre veprave, Institucionet si dhe veprimet të cilat ato i marrin për të luftuar këtë veprimtari. Sjellejt kundërzgjedhore kryhen nga persona ose subjekte të thjeshtë, por edhe nga persona të autorizuar zyrtarë të lartë shtetëror.

Ky punim nxjerrë rezultate përfundimtare të marra edhe nga organizatat e ndryshme joqeveritare të cilat kanë ndihmuar në pasqyrimin më të qartë të mbajtjes së zgjedhjeve të kësaj periudhe. Statistikat e tyre merrem si të sakta nga organizata e jashtme ndërkombëtare pasi ato tek këto organizata shohin shprehjen e fjalës së lirë.

KAPITULLI I PARË

1. Njohuritë e përgjithshme për veprat penale kundër zgjedhjeve

1.1 Nocioni, llojet dhe karakteristikat e veprave penale kundër zgjedhjeve

Në një shtet sovran dhe demokratik siç është Republika e Maqedonisë së Veriut, e drejta e votës është e lirë dhe e mbrojtur me Kushtetutën, Kodin Zgjedhor të Republikës dhe me të drejtën ndërkombëtare të cilat ndihmojnë në mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe të barabarta para ligjit. Çdo mosrespektim i ligjit dhe Kodit Zgjedhor çon në kundërvajtje dhe kryerje të veprës penale kundër zgjedhjeve të lira dhe të barabarta.

Vepra penale si nocion i përgjithshëm nënkupton veprën apo sjelljen e njeriut e cila dëmton apo revokon vlerat elementare të njeriut, të shoqërisë dhe të sistemit juridik¹. Kjo sjellje e njeriut në rastin konkret bie në kundërshtim me ligjin e zgjedhjeve dhe paraqet veprë penale kundër zgjedhjeve.

Vepra penale kundër zgjedhjeve kryhet nga dy subjekte pjesëmarrëse në zgjedhjet;

- Votuesit
- Kandidatët²

Këto dy subjekte në vete thurin dhe ndërthurin edhe kryerësit e vet veprave penale, votuesit të cilët nuk e shfrytëzojnë në mënyrë të drejtë të drejtën e lirë dhe demokratike për të votuar, por e keqpërdorin atë në të gjitha mundësit. Kandidatët e zgjedhjeve aktuale shfrytëzojnë votuesit për t'ia arritur qëllimit duke përdorur gënjeshttrat, premtimet, dhënien e rufshfeti dhe shumë mënyra të tjera vetëm që të arrijnë në synimin kryesor, në fitore.

Votuesit janë qytetarët të cilat sundojnë të drejtën e votës së lirë dhe demokratike, por duke u besuar premtimeve të kandidatëve të zgjedhjeve aktuale, ato marrin pjesë duke mbrojtur anën e këtyre kandidatëve dhe plotësojnë kërkesat e tyre ligjore dhe joligjore në ditën e zgjedhjeve. Veprimet e tyre joligjore të cilat shkelin votën e lirë i bëjnë përpara ligjit kryes të veprës penale të zgjedhjeve.

¹Dr. Ismet Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, faqe 179, Prishtinë 2005

²Dr. Mahi Nesimi, Doracak terminologjik për zgjedhje, faqe 7, Tetovë 2020

Nëse flasim në anën tjetër për kandidatët e zgjedhjeve aktuale, ato mund të jenë deputetë, këshilltarë, kryetarë partie, kryetarë të komunave, qytetëve, ministra..etj, të cilat financohen nga parti të fuqishme për t'ia aritur qëllimit- fitoren.

Mbajtja e zgjedhjeve të lira, demokratike në të vërtetë pasqyron shprehjen e lirë të qytetarëve dhe u mundëson atyre të zgjedhin përfaqësuesin e tyre të cilin ato mendojnë se mund t'i përfaqësojë mendimet e tyre lidhur me të mirat dhe ndryshimet që mund të ndodhin në vendin që ato jetojnë. Kjo nuk ndodh në Republikën e Maqedonisë së Veriut sepse vitpas viti nuk respektohet e drejta e votës së lirë, por fuqia e korupsionit merr hov sa më të madh duke çuar në të ashtuquajturën fenomen “blerje e votës së lirë”.

Ky fenomen është edhe vetë esenca e fillimit të kryerjes së veprës penale sepse kemi shkelje të ligjit nga të dyja anët pjesëmarrëse në zgjedhje. Ky fenomen cënon lirinë e zgjedhjes është i dëmshëm për shoqërinë në të cilën një subjekt garues me qëllimin e grumbullimit të sa më shumë votave ofron para për të siguruar ato.

Një vepër penale e pashkruar e cila ndër vite ka qënë shumë e pranishme në mbajtjen e zgjedhjeve në RMV është “treni bullgar”, biles ky fenomen cilësohet si më i rezikshmi edhe pse me avancimin e ligjeve në shtet nuk është më i pranishëm si më parë. Në të shumtën e rasteve janë gjetur fleta të bardha në kutiat e votimit, që do të thotë se votuesit i kanë marrë me vete fletat origjinale të votimit dhe kanë futur ndonjë flet dosido. Fletat e votimit pasi janë nxjerrë prej vendvotimeve janë dorëzuar tek militantë partiakë jashtë qendrës së votimit dhe pasi janë plotësuar jepen votuesëve të radhës. I njëti fenomen vazhdon me votues të tjerë dhe mund të zgjasë gati gjithë ditën. Kjo ndodh në rastet e blerjes së votës ku militantët partiakë janë më të sigurtë në atë se personave që u japin para e plotësojnë kërkesën e tyre. Kjo formë e manipulimit është përhapur për herë të parë në zgjedhjet në Bullgari dhe për atë arsye edhe quhet “treni bullgar”.

1.2 Llojet e veprave penale kundër zgjedhjeve

Llojet e veprave penale kundër zgjedhjeve të lira dhe demokratike sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të percaktuara dhe të klasifikuara si më poshtë:

1. Pengimi i zgjedhjeve dhe i votimit(neni 158)
2. Shkelja e së drejtës zgjedhore(neni159)
3. Shkelja e lirisë së përcaktimit të zgjedhësve (neni160)
4. Keqpërdorimi i së drejtës zgjedhore(neni161)
5. Korrupsioni gjatë zgjedhjeve dhe votimi(neni 162)
6. Cënimi i fshehtësisë së votimit (neni 163)
7. Shkatërrimi i dokumenteve zgjedhore (neni164)
8. Mashtrimi zgjedhor (neni 165)
9. Keqpërdorimi i mjeteve për financimin e fushatës zgjedhore (neni165-a)
10. Shqiptimi obligativ i dënimit, ndalim për kryerjen të profesionit, veprimtarisë apo detyrës (neni 165-b)³

1.3 Karakteristikat e veprave penale kundër zgjedhjeve

E drejta e pjesëmarrjes në zgjedhje të lira dhe korekte bashkë me metodat dhe karakteristikat e saja, si dhe mënyrat e mbajtjes së tyre janë shtylla kryesore e një shteti i cili quhet shtet demokratik. Vetë mbajtja e procesit zgjedhor legjitim paraqet edhe vetë respektimin e ligjit të shtetit sovran dhe demokratik, si dhe plotëson kërkesat e popullatës. Këto kërkesa dhe dëshira janë të përfshira në ligj dhe mbrohen me ligj.

Në momentin që nuk respektohen rregullat dhe ligji gjatë procesit zgjedhor, kemi të bëjmë me vepër penale kundër zgjedhjeve dhe po këta kundërligjshmëri që ndodhin gjatë procesit zgjedhor pengojnë edhe mbajtjen e procesit zgjedhor. Disa nga karakteristikat e së drejtës zgjedhore mund të definohet e drejta e votës së lirë, e barabartë dhe e fshehtë ose thënë ndryshe “një votues-një votë”.

Në kapitull të veçantë në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të percaktuara dhe të rregulluara nene me të cilat përcaktohen se cilat sjellje të njerëzve gjatë mbajtjes së procesit zgjedhor janë ose konsiderohen si të kundërligjshme .

³ Doc.Dr.Afrim Osmani, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, faqe 151,152,153,154,155,Shkup 2010

Me vetë ndalimin e kryerjes së veprës penale si **Pengimi i zgjedhjeve dhe i votimit(neni 158)** ndihmon në ndërgjegjsimin e subjekteve që të mos ndalojnë procesin e zgjedhjeve ose votimin e lirë. Kjo vepër mundet të kryhet nëpërmjet përdorimit të dhunës fizike si dhe psikike, kërcënimit, si dhe mënyra të tjera për t'ia arritur qëllimit e mosshpalljes së rezultateve të zgjedhjeve ose manipulimin me ato.

Nëpërmjet veprës penale **Shkelja e së drejtës zgjedhore(neni159)** mbrohet pjesëmarrja pasive dhe aktive e votuesve dhe e drejta për të votuar dhe realizimi i drejtë i asaj. Karakteristika e këtij neni qëndron tek votuesit dhe mbron të drejtën e votës së tij të votojë, të jetë i votuar ose të zgjedhë të drejtën e tij për të votuar.

Zgjedhje të lira dhe demokratike janë shtylla kryesore në një shtet demokratik dhe me përcaktimin e nenit **Shkelja e lirisë së përcaktimit të zgjedhësve (neni160)** mbrohet e drejta e lirisë për të vendosur votuesi vetë a dëshiron të kandidohet për zgjedhje ose nuk dëshiron apo dëshiron të dalë në zgjedhje ose nuk dëshiron të dalë dhe të votojë, dhe e drejta e tij për cilin do të votojë. Ky nen e mbron subjektin edhe prej kërcënimeve për të mos vendosur vetë në atë se në çfarë forme dëshiron të jetë pjesëmarrës në zgjedhje, e mbron nga kërcënimet e njëpasnjëshme që mund t'i ketë, të cilat dënohen nëpërmjet këtij ligji.

Keqpërdorimi i së drejtës zgjedhore(neni161) nënkupton vetë subjektin pjesëmarrës në procesin zgjedhor. Procesi zgjedhor është një proces i gjatë dhe shumë mirë i përcaktuar që të mos ketë parregullsi duke filluar nga aspekti kryesor ku çdo qytetar i thjeshtë i cili ka mbushur 18 vjet dhe është i aftë për të votuar ka të drejtë e votës së lirë, dhe i njëjti është pjesëmarrësi kryesor në procesin zgjedhor. Nëse dikush cënon të drejtën e tij atëherë kemi të bëjmë me shkelje të ligjit, votimi në vend të dikujt tjetër dhe me këtë veprim cënon të drejtë e tij për të votuar.

Korrupsioni gjatë zgjedhjeve dhe votimi(neni 162) është neni ku si karakteristik përmban miton ose rushfetin gjatë zgjedhjeve. Kemi dy lloj të rushfetit dhe atë kemi persona të cilëve u ofrohet para, dhënie ose premtime të ndonjë vlerë monetare ose premtime të tjera për përdorimin, mospërdorimin ose përdorimin e votës së tij për dikë tjetër, ose nga ana tjetër kemi persona të cilët presin që t'u ofrohet shpërblim, premtim ose ndonjë vlerë monetare për përdorimin e votës së lirë ose thënë ndryshe persona të cilët i caktojnë vlerë votës së tyre.

Në zgjedhje të lira vota e fshehtë është edhe kusht kryesor e cila mbrohet me po këtë nen **Cënimi i fshehtësisë së votimit (neni 163)** në Kodin Penal. Asnjë nuk ka të drejtë të

detyrojë tjetrin të tregojë se për cilin subjekt voton. E drejta e fshehtësisë së tij duhet të ruhet dhe të respektohet dhe kjo e drejtë nuk duhet t'i cënohet askujt. Sekretin e votimit do të thote se askush në asnjë mënyrë nuk duhet ta kuptojë se si dikush tjetër e ka realizuar të drejtën e tij të votimit.⁴

Shkatërrimi i dokumenteve zgjedhore (neni164) denohet ashpër me ligj dhe dokumentet zgjedhore duhet të ruhen në fshehtësi deri në momentin e hapjes së tyre për popullatën e gjërë. Sigurimi dhe ruajtja e materijalit është edhe kusht kryesor për të vërtetuar mbajtjen e vet procesit zgjedhor. Si materijal zgjedhor merren fletvotimet, libri i emrave dhe mbiemrave të votuesve, procesverbale të komisionit zgjedhor etj.,.

Në një proces zgjedhor nëse gjithçka shkon sipas rregullave fillon dhe mbaron me një fitues ose shumë fitues, varet nga lloji i zgjedhjeve, por në fund të çdo procesi mund të kemi parregullsi dhe paraqitje të rezultateve të gabuara, të rreme ose të fallsifikuara. Kjo arrihet duke fallsifikuar fleta votimi. Kjo vepër penale mbrohet me nenin **Mashtrimi zgjedhor (neni 165)** i cili ndërthur në vete dënimet ose sanksionet që mund t'u shqiptohen subjektve që keqpërdorin rezultatet zgjedhore.

Ekziston ligj i cili mbron të drejtë e barabartë të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor dhe atë dënon keqpërdorimin e financimit të ndonjë kandidati në fushatën e tij. Vetë fushata zgjedhore nuk guxon të financohet nga mjetet e Buxhetit të Republikës me disa përjashtime, por edhe vetëfinancimi nga persona ose organizata të huaja kanë të përcaktuar vlerën deri ku mund të mbërijë. Shteti ndjek dhe zbulon financimet e fushatave zgjedhore dhe atë se prej ku vijnë këto të ardhura dhe a janë të ligjshme. Kjo është e përfshirë në nenin **Keqpërdorimi i mjeteve për financimin e fushatës zgjedhore (neni165-a)**. Në vetë nenin kërkohet paraqitja e një raporti financiar se prej ku e kanë prejardhjen dhe sa janë harxhuar gjatë fushatës zgjedhore e cila ka edhe minimumet dhe maksimumet e saja të përcaktuara me ligj.

⁴Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë: me amendamentet e Kushtetutës I-XXX), Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shkup, 2007

KAPITULLI I DYTË

2. Zgjedhjet, sistemi zgjedhor dhe llojët e sistemit zgjedhor

2.1 Vështrim historik i zgjedhjeve në të kaluarën në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në historikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut prej ditës së pavarësisë janë mbajtur Zgjedhje Parlamentare, Zgjedhje Presidenciale dhe Zgjedhje Lokale si dhe Referendum. Protagonistë të zgjedhjeve qytetarët e ndonjë partite politike të cilat janë të shumta në republikën tonë. Në fillimet e hershme kanë qënë partia VMRO dhe LSDM nga ana e popullatës maqedonase dhe PDP dhe PPD nga e popullatës shqiptare, e më vonë edhe formimi i partisë BDI poashtu e popullatës shqiptare. Meqe RMV-ja është shtet shumë nacional ekzistojnë edhe parti të nacionaliteteve të tjera të vogla.

Partia e parë shqiptare ishte **Partia për Prosperitet Demokratik** e regjistruar në Tetovë. Pjesa më e madhe e shqiptarëve u regjistruan në këtë parti të cilët dëshironin që të meren me çështje politike-shoqërore të asaj kohe. Mendimet e antarëve të kësaj partie ndaheshin në tri grupe:- grupin e parë e përbënin intelektualë të rinj, -grupi i dytë ish të burgosur politik dhe në grupin e tretë persona që braktisën mendimet komuniste dhe kërkonin strehim në një subjekt të ri politik. Kjo parti e parë shqiptare u mundua me gjithë forcat që të mbrojtë të drejtat e shqiptarëve por nuk ishte e lehtë. Në zgjedhjet e para parlamentare në thirrje të partive politike shqiptare, diaspora merr vrrullin dhe rrugët e gjata për të votuar për deputetët shqiptarë, gjë e cila nuk u prit mirë nga pala maqedonase, ku filloi demonstrata nëpër rrugët e Gostivarit duke brohoritur “ Vdekje për shqiptarët”, Vdekje për PPD-në”, “Maqedoni e pastër”. Edhe pse presidenti i parë në shtetin Sovran, Kire Gligorov, u zgjodh fal votave të shqiptarëve dhe ai asnjëher nuk i përmendi shqiptarët, por përkundrazi në çdo aspekt i përbuzëte ata.⁵

Partia për Prosperitet Demokratik e shqiptarëve ishte partia e dytë e regjistruar në RMV si parti shqiptare e përbërë nga subjekte të larguara nga PPD-ja dhe pjestarë të rinj. Kjo parti u themelua me vitin 1995, por haste në vështirësi shumë të mëdha pasi haptazi luftonte subjektet maqedonase duke mbrojtur të drejtat e shqiptarëve. Në këtë kohë u formua edhe

⁵Partia Demokratike shqiptare, Lindja zhvillimi dhe veprimtaria, Zeqirja Rexhepi, Tetovë 2004,faq.33

Universiteti i Tetovës i cili në asnjë mënyrë nuk pranohej nga pala maqedonase dhe nga vetëkryetari i shtetit i cili në një citat thotë:

“ Që kur Universiteti u formua në livadh në fund të vitit 1994, njëherë në një bisedë tek unë ishte kryetari atëherëshëm i PPD-së, Abdurrahman Alitit, dhe sipas Gligorovit, Aliti ka thënë; Unë fëmijën tim nuk do ta dërgoj në atë Universitet në Reçicë të vogël, do të bëj gjithçka që ai të mësojë në këto dy Universitet (në Shkup dhe Manastir) ose jashtë vendit⁶ “

Bashkimi Demokratik për Integrim është partia e cila u formua pas luftës në vitin 2001 dhe ishte e formuar nga pjestar të ish-Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) në Maqedoni në krye me Ali Ahmetin. Selia e kësaj partie qëndron se është në Shkup, por ajo qendrën e ka në Reçicën të Vogël të Tetovës. Pasi korri fitore më vitin 2001 në Zgjedhjet Parlamentare, më vitin 2008 BDI-a arriti marrëveshje me partinë VMRO dhe fiton 5 ministra, 3 zëvendës ministra dhe gjithashtu një kryetar parlamenti. Këto i arriti në zgjedhjet e parakohshme ku mori 18 deputetë kundër 11 deputetëve të PDSH-së së Mendu Thaçit.

Aleanca për Shqipëtarët- ASH është parti e formuar më vitin 2016 në Shkup e përbërë prej anëtarëve të Lëvizjes për Reforma në Partinë Demokratike Shqiptare, që drejtohet nga Zeadin Sela⁷. Synimi kryesor është barazimi i shqiptarëve dhe maqedonasve në të gjitha sferat investimet, përfaqësimi institucional, përfaqësimi i barabrtë në institucionet shtetërore, punësimet dhe shumë sfera të tjera. Me zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 kjo parti fitoi 3 deputetë, ndërsa në zgjedhjet komunale në vitin 2017 dhe 2021, ku fitoi 3 qytete për kryetar komune, ndër to edhe Strugën.

Lëvizja Besa- u formua me 23 mars të 2015 në Shkup me kryetar Bilal Kasami me synim kryesor përfaqësimin e të drejtave të shqiptarëve në institucionet e shtetit dhe atë duke kërkuar barazinë, drejtësinë, lirinën dhe prosperitetin.⁸ Kjo parti luftën më të madhe e ka me institucionet duke kërkuar në ndryshimin e rrjedhjes së tyre të cilat i shkelin të drejtat e shqiptarëve. Në zgjedhjet e vitit 2016 kjo parti fitoi 5 deputetë, ndërsa në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020 kjo parti doli në koalicion me partinë e LSDM-së.

⁶K.Gligorov, Makedonija e sve sto imame, Kultura, Skopje, 2002, faq.170

⁷Për më tepeër shih në ueb faqen e Alternativës:<https://alternativa.mk/>.

⁸Për më tepeër shih në ueb faqen e Lëvizjes Besa:<https://levizjabesa.mk/>.

Nga pala maqedonase kemi partin **Lidhje Socialdemokrate-LSDM**, e formuar në fillim me emrin Partia për Ndryshime Demokratike me kryetar Branko Cërvenkovski⁹. Lidhja Socioldemokrate e Maqedonisë është anëtare e Aleancës Progresive dhe një shoqërues i asociuar i Partisë së Socialistëve Evropiane. Me vitin 2002 partia maqedonase mori fuqinë më të madhe ku fitoi 60 deputetë nga 120 gjithësej, por pati një defacto ne vitin 2008 ku mori vetëm 27 deputetë nga 120 gjithësej. Kthimin më të fuqishëm LSDM-ja e kishte pas zgjedhjeve të vitit 2014 ku humbën nga VMRO-ja, por nuk e pranon humbjen dhe fillon protestat shumëditore të cilat edhe përfshihen me publikimin e inçizimeve ose materialeve ku popullata në RMV kishte qënë e përgjuar nga përfaqësuesit e pozitës, pra spiunim i paligjshëm nga ana e Nikolla Gruevskit, kryeministër i asaj kohe i më shumë se 20.000 qytetarë. Gjithë këto protesta të vazhdueshme sollën deri në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Më vitin 2016 mbahen këto zgjedhje të parakohshme në të cilat LSDM-ja fiton 46 deputet në parlament.

Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase-Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonasose **VMRO-DPMNE** është partia e dytë më e madhe maqedonase në Republikën e Maqedonisë.¹⁰ Partia qëndrimet i paraqet si Kristiano-demokratike, por ajo në të vërtet konsiderohet nacionaliste. Synimet e tyre bazohen në “maqedonin etnike” me disa përjashtime. Në fillimet e saja kryetar ka qënë Ljupço Georgievski, por në politikën e udhëheqjes në kohën e tij është akuzuar se ka qënë probullgar. Në kohën e Nikolla Gryevskit si kryetar i VMRO-DPMNE-së synimet kryesore kanë qënë ultra- nacionaliste, kunë të shumtën e rasteve edhe antishqiptare. Edhe pse në paraqitjet e para partia ka qënë proevropiane dhe proNATO, më vonë ndryshojnë drejtimin në pro ruse, pro-sërbe dhe antiperëndimore.

Levica- është parti e maqedonasve e formuar më vitin 2015 e cila në praktik është parti e fortë nacionaliste e cila i mbron fort të drejtat e maqedonasve.¹¹ Ka ideologji majtiste dhe mbron vlerat e majta ndërsa si focus kryesor paraqitet si parti që mbron të arfërit, të

⁹ Për më tepeër shih në ueb faqen e LSDM-së:<https://sdsm.org.mk/>.

¹⁰ Për më tepeër shih në ueb faqen e VMRO-DPMNE-së:<https://vmro-dpmne.org.mk/>.

¹¹ Për më tepër shih në faqen e uebit te Levica:<https://levica.mk/>.

paprivilegjuarit, të magjinalizuarit dhe të shtypurit. Presidenti aktual është dr.Dimitar Apasiev. Në zgjedhjet parlamentare të viti 2016 kjo parti fitoi 12.120 vota (1.02%), ndërsa në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të v. 2020 fitoi 2 mandate parlamentare dhe për herë të parë ka deputetët e saj në Kuvend.¹²

¹²Po aty.

Zgjedhjet parlamentare

Deri në ditën e sotme janë mbajtur dhjetëherë (10) zgjedhje parlamentare në RMV, dhe në vete përmbajnë rregullsitë dhe parregullsitë e tyre. Paraqesim një grafik në atë se kush ishte pjesëmarrës dhe kush fitoi ndër vite. Duhet të cekim se ka pasur edhe zgjedhje të parakohshme:

Partit ë politik e	SRS	VMRO- DPMN E	LSDM	PPD/ PDSH	BDI	ASHA	Të pavarur	Levica	Besa	VMRO- PO
v.1990	11	38	31	17	/	/	/	/	/	
v.1994	/	38	31	17	/	/	/	/	/	
v.1998	/	49	27	8	/	/	/	/	/	
v.2002	/	33	60	9	16	/	/	/	/	
v.2006	/	32	60	11	17	/	/	/	/	6
v.2008		33	60	11	16					6
v.2011		63	27	8	18					
v.2014		56	42	8	15					
v.2016		51	49	2	10	3			5	
v.2020		46	44	2	15	12				

Zgjedhjet e para Parlamentare u mbajtën në nëntor të vitit 1990 dhe përfunduan në rrethin e dytë në 25 nëntor 1990¹³. Ishin zgjedhje në të cilat për herë të parë votoheshte në një shtet të pavarur e shumëpartiak. Partia VMRO-DPMNE fitoi më shumë deputetë dhe atë 38

¹³Republička izborna komisija, Izbori '90- Konečni rezultati od izborite ya pratenicite vo Sobranieto na SR Makedonija, Hronoloshki pregled na tekot na rezultatite od izborite, Skopje, 27 dekemvri 1990,1

të cilët nuk mjaftonin për të formuar qeverinë dhe pasi nuk arriti të bëjë koalicion, formohet qeveri teknike. Pikëpyetje kryesore e këtyre zgjedhjeve qëndronte në atë se a duhet të jetë Republika e Maqedonisë së Veriut ende pjesë e ish -Jugosllavisë, të cilën shumica nuk e pranonte. Dalja ishte diku 84.8%, ndërsa në raundin e dytë 76.8%.

Në historinë e RMV-së zgjedhje parlamentare, të cilat më tepër kanë bërë bujë dhe kthim më të fuqshën të popullatës shqiptare, kanë qënë zgjedhjet e vitit 2002, ku pas konfliktit të vitit 2001 shqiptarët e UÇK-së formojnë partinë e BDI-së e cila fitoi 16 deputetë. Këto janë edhe zgjedhjet e para që mbahen pas nënshkrimit të marrëveshjes së Ohrit dhe mbikëqyrja nga ana e organizatave joqeveritare dhe atyre të huajave ishte shumë e madhe. Një arritje e madhe për shqiptarët në këto zgjedhje ishte edhe aplikimi i modelit proporcional për ndarjen e të gjithë 120 vendeve të deputetëve, ku territori i RMV-së është i ndarë në gjashtë njësi zgjedhore. Në zgjedhjet e mbajtura dolën 76.4% e popullatës. Në këto zgjedhje partia e re shqiptare Bashkimi Demokratik për Integrim u bë pjesë e qeverisë në koalicion me partinë maqedonase LSDM e cila ndihmoi për avancimin e të drejtave për popullatën shqiptare. Pjesëmarrja e kësaj partie shqiptare ndihmoi në avancimin e votimeve të ligjeve të reja në favor të shqiptarëve dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre në disa institucione.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2008 ishin zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe kjo erdhi për shkak të prishjes së koalicionit qeveritar. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut e përcakton në nenin 63 ku thuhet:” Kuvendi shpërndahet nëse për të deklarohet shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Zgjedhje tjetër për shpërndarje të parlamentit nuk parashihet”.¹⁴

Pakënaqësitë filluan menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve të vitit 2006 ku partia fituese VMRO-DPMNE-ja refuzoi të krijoi koalicion me partinë e BDI –së ,por krijoi me PDSH-në e cila kishte fituar më pak deputetë nga pala shqiptare. Sherret dhe trazirat vazhduan për një vit derisa u prish koalicioni dhe nuk mundej të krijohet koalicion i ri. Partia e BDI-së u mundua nëpërmjet bllokimit të parlamentit të shprehë pakënaqësinë e tyre dhe atë paraqiti mbi 4.000 amendamente, shqyrtimi i të cilave do të zgjaste deri në pafundësi.

¹⁴Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 63

Zgjedhjet presidenciale

Partia	VMRO-DPMNE	LSDM
v.1994	21.6%	78.4%
v.1999	53.2%	46.8%
v.2004	37.4%	62.6%
v.2009	63.1%	36,86%
v.2014	55,28%	41,14%
v.2019	44.75%	51.65%

Zgjedhjet e para Presidenciale u mbajtën bashkë me Zgjedhjet Parlamentare. Në këto zgjedhje kandidonin dy kandidatë të dy partive më të mëdha maqedonase, LSDM-së në koalicion me Bashkim për Maqedonin dhe VMRO-DPMNE-në, të cilat përfunduan me fitoren e koalicionit me kandidat Kiro Gligorov. Koalicioni zgjedhor quajmë grupimin e subjekteve politike në një subjekt garues me qëllim të ngadhënjimit në zgjedhje dhe të marrjes së pushtetit¹⁵.

Kandidat shqiptar në Zgjedhjet Presidenciale ka pasur, por jo me ndonjë sukses të madh për çka në fund është dashur koalicioni i anës maqedonase me votat shqiptare për të fituar kandidati i tyre për president. Kryetari ose presidenti i fundit i zgjedhjeve të v.2019 është Stevo Pendarov, i cili ende është president i Republikës së Maqedonase së Veriut.

Nëse flasim për rolin e presidentëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas mendimit tim nuk kanë luajtur ndonjë rol të fuqishme në ndryshimet në shtet, biles nëse flasim për ish-presidentin, Gjorgji Ivanov, ai fare nuk figuronte si president dhe nuk e paraqiste fuqinë e tij ,vetëm në rastet kur duheshite të bëjë faljet e të dënuarve të cilët 99%

¹⁵Dr.Mahi Nesimi, Doracak terminologjik për zgjedhje, faqe 31, tetovë 2020

ishin pjesëtar të partisë së tij dhe ishin falje të papranueshme për drejtësinë në vend siç ishte konkretisht falja e ish-kryeministrit të shtetit tonë, Nikolla Gruevski, i cili sot edhe kësaj dite ndodhet në arrati.

Zgjedhjet komunale

Partia	VMRO-DPMNE	LSDM	BDI	BESA	AA	PPD	PDSH	VMRO-PO	TË PANVARUR
v.1996									
v.2000									
v.2005	21	14	37				2	3	7
v.2009	56	15	7				1		3
v.2013	56	14	4				2		2
v.2017	5	57	10	1	3		1		
v.2021	42	16	11	2	3		1		

Zgjedhjet komunale janë zgjedhjet të cilat ngrejne pikëpyetje të madhe në mbajtjen e tyre si dhe në atë se cili fiton për kryetar komune. Me sjelljen e ligjit të vetëqeverisjes lokale më 7 nëntor 2004 u hap një mundësi e re për shqiptarët.

Zgjedhjet e mbajtura me v.2005 ishin zgjedhjet e para pas decentralizimit dhe si të atilla ishin të paraqitura shumë ankesa lidhur me parregullsit të shumta. Nuk u përmbushën standartet kryesore ndërkombëtare për barazinë dhe fshehtësinë e votës së lirë. Këto zgjedhje u mbajtën në 84 komuna në të gjithë territorin e Republikës dhe Shkupit si njësi e veçantë e

vetëqeverisjes lokale. Vëzhguesit më të mëdhnj ishin nga OSBE/ODIHR¹⁶ si organizata ndërkombëtare. Në këto zgjedhje fiton partia VMRO-DPMNE, por fuqishëm edhe partia e BDI-së nga pala shqiptare¹⁷.

Zgjedhjet e para lokale ne Republikën e Maqedonisë së Veriorit u mbajtën në vitin 1996, me dalje mesatare të qytetarëve, por me anulimin e mbajtjes së procesit zgjedhor në shumë qytete për shkak të parregullsive. Në mbajtjen e zgjedhjeve lokale të vitit 1996, përveç partive maqedonase morën pjesë edhe tri parti shqiptare: Partia për Prosperitet Demokratik (PPD), Partia për Prosperitet Demokratik e Shqiptarëve (PPDSH) dhe Partia Demokratike Popullore(PDP), ku lufta kryesore politike në këto zgjedhje u zhvillua kryesisht në mes dy krahëve të ish-PPD, Partisë për Prosperitet Demokratikë (rryma e vjetër) dhe Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (rryma e re).¹⁸ Tek këto zgjedhje u shënua edhe një fitore e madhe e palës shqiptare e cila fitoi 9 komuna bindshëm bashkë me qytetin e Shkupit dhe Tetovës. Kjo ishte edhe fillimi i sadopak shprese tek pala e shqiptarëve, ku me ndërrimin e udhëheqësve maqedonas në ndërmarrjet e shumta filluan të punësohen edhe shqiptarë.

Pas mbajtjes së këtyre janë mbajtur edhe gjashtë herë zgjedhje të tjera demokratike dhe të lira. Në mbajtjen e zgjedhjeve janë shënuar një numër i madh i shkeljeve të të drejtave të qytetarëve, sidomos nga ana e popullatës shqiptare, të cilëve nuk u njiheshin të drejta të barabarta, por me ndryshimin e kushtetutës dhe përfshirjen e vëzhguesve nga ana e OSBE/ODIHR-it të cilët vëzhgonin të gjithë procesin zgjedhor diçka edhe ndryshonte.

Në zgjedhjet lokale të mbajtura për herë të parë në vitin 2005 në nivel lokal, si lojtar politik u paraqet edhe BDI, partia e Ali Ahmetit e cila fitoi kryetarë komunash, në: Gostivar, Dibër, Strugë, Tetovë, dhe shumë vendbanme tjera shqiptare.¹⁹

¹⁶ОБСЕ/ОДИХР Канцеларија за демократски институции и човекови права, поранешна југословенска Република Македонија, Локални избори 12 и 27 март и 10 април. Конечен извештај на Мисијата за наблудување за избори на ОБСЕ/ОДИХР. Варшава, 2005

¹⁷Пër më tepër për zgjedhjet lokale të v.2005 shih në: Јане Димески; марко Панковски, прирачник за локални избори во република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр.26-27

¹⁸Partia politike e quajtur “rryma e re” u rregjistrua me emrin ; Partia për Prosperitet Demokratik e Shqiptarëve- “PPDSH”, me Vendimin e sjellur më datë 18.04.1995, Slluzhben vesnik na Republika makedonija, br.41/94

¹⁹Пër më tepër në://portalb.mk/443272-analijë-dosje-te-gjitha-zgjedhjet-lokale-ne-maqedoni/.

Referendum

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë mbajtur 3 referendume dhe atë :

Në vitin 1991 u mbajt **Referendumi i parë** në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku si çështje esenciale ishte pyetja nëse duhet apo jo RMV-ja të qëndrojë si pjesë e ish-Jugosllavisë apo të bëhet shtet i pavarur dhe demokratik. Në referendumin e mbajtur morën pjesë 72% e popullatës ku 95% prej tyre u deklaruan për PO pavarësisë së Maqedonisë si shtet sovran dhe i pavarur. Pas shpalljes së pavarësisë presidenti i shtetit, Kiro Gligorov, iu drejtua popullatës së mbledhur me fjalët:” Të dashur qytetarë të Maqedonisë, më lejoni që sot ju dhe të gjithë qytetarëve të Maqedonisë, t’ua uroj Maqedoninë e lirë, sovranë dhe të pavarur.”

Referendumi i dytë i mbajtur në vitin 2004 rezultoi zhgënjim total për shkak të mosdaljes së popullatës për të votuar. Si çështje kryesore ishte Ligji për Decentralizim Lokal, por për shkak të mosdaljes ky referendum nuk u mor si për bazë. **“Ligji i Decentralizimit ose Vetqeverisjes Lokale ishte një plus i madh për vendet me popullatë shqiptare”**dhe si i tillë në fund u votua në kuvend edhe pse referendumi nuk shkoi si duhet.

Pas trazirave të shumta të një pasnjëshme në shtetin tonë dhe dëshira e madhe për hyrje në Bashkimin Evropian kërkonin plotësimin e disa kushteve dhe, ndër të cilat kryesorja ndryshimin e emrit të shtetit, për shkak se Greqia nuk pranonte se emri është i vjetër dhe autototm dhe se është i vjedhur prej tyre. Po në Greqi ekziston një fshat i vogël i quajtur Maqedoni. Kjo ndoshta ishte edhe një ndër sfidat më të madhatë partiesë qeveritare. Ajo tashmë kishte fituar besimin e popullit pas arritjes së rëzimit të partiesë 10 vjeçare në pushtet, por kjo sfidë e cila rëzonte besimin në historinë e shtetit ishte shumë e madhe. Në ndihmë për të plotësuar këte kërkesë kaq të madhe, në parlament u votua mbajtja e referendunit e cila do të vinte në pikëpyetje a duhet apo jotë ndryshohet emir i shtetit.

Për këtë arsye në vitin 2008, në kohën kur Republika e Maqedonisë së Veriut tashmë ishte pjesë e OKB-së dhe synonte Bashkimin Evropian, kishte ardhur koha për të shënuar edhe fundin e mosmarveshjeve me shtetin grek. Në fillim kishte shumë negativitet nga ana e opozitës, por dy javë para mbajtjes së **Referendunit të tretë**, udhëheqësi i opozitës, Hristija Mickoski, doli me qëndrim se popullata duhet të dalë dhe të votojë sipas qëndrimeve të veta dhe se partia do t’i mbështesë në çfardo qoftë qëndrimi të tyre, pasi që ky proces është i nevojshëm për shtetin. Në shumicën e popullatës pjesëmarrëse në referendum u votua PËR

ndryshimin e emrit gati 91%. Ky referendum ndihmoi shumë shtetin tonë në avancimin e negociatave për hyrje në Bashkimin Evropian pasi që me ndryshimin e emrit u mbyll një mosmarveshje shumë e zgjatur dhe stërzgatur me Republikë e Greqisë.

Referendumi i parë A duhet shteti të jetë pjesë e ish-Jugosllavisë apo shtet i pavarur 8 shtator v.1991			Referendumi i dytë Ligji i Decentralizimit ose Vetqeverisjes 7 nëntor v.2004			Referendumi i tretë Ndryshimi i emrit në Republika e Maqedonisë së Veriut 28 qeshor v.2008		
pro	kundër	abstenim	pro	kundër	abstenim	pro	kundër	abstenim
96%	4%	/	95 %	4%	1%	49%	22%	13%

Cënimi i së drejtës në pjesëmarrje në referendum është i njëjtë si cënimi i së drejtës në zgjedhje dhe ligji i dënon dhe i mbron të dyja në mënyrë të njëjtë. Referendumet nuk do të ishin të vlefshme në RMV, nëse nuk do të ishte pjesëmarrja e shqiptarëve por pala maqedonase asnjëherë nuk ua respektoi këtë pjesëmarrje të shqiptarëve edhe pse në të vërtetë ajo është e drejta e tyre si shtetas të këtij shteti.

2.2. Mashtrimet zgjedhore dhe korrupsioni gjatë zgjedhjeve dhe votimit

Mashtrimet zgjedhore ndër vite në historinë e shtetit tonë kanë qënë të shumta dhe të panumërta të cilat në shumicën e rasteve kanë përfunduar si lëndë të pazgjedhura në gjykatat e shtetit. Mashtrimi më i madh i historisë, i cili bëri edhe bujën më të madhe duke e treguar fuqinë e personave të cilët e udhëheqin shtetin dhe dështimin më të madh të institucioneve shtetërore të cilët lejojnë që këto mashtrimë të zbulohen shumë vonë, atëherë kur pasojat janë teje të mëdha, ishin zgjedhjet e viteve 2012 të cilat rezultuan se kishin qënë të korruptuar dhe atë në hapasi.

TITANIK-është lënda gjyqësore e cila e paraqet të ashtuquajturën mashtrim më i madh zgjedhor i cili u zbulua pas shumë vitesh ose thënë ndryshe mashtrim i cili ndihmoi partinë e atëherëshme VMRO-DPMNE të arijë të qëndrojë në krye të shtetit për edhe shumë vite. Ky mashtrim ka ndodhur në zgjedhjet parlamentare të vitit 2012 dhe kryesonte nga funksionarë të lartë të asaj kohe, kryeministri i asaj kohe, Nikola Gryevski, i cili edhe sot e kësaj dite është ende në arrati, ish-sekretari i Qeverisë Kiril Bozhinovski, ministri i punëve të mbrendshe, Gordana Jankuloska, ish-ministri i transportit Mile Janakieski, ish-zëvendës ministrja e drejtësisë, Biljana Boshkovski dhe shumë funksionar të tjerë, ministra, noterë, gjyqtarë, antarë të KSHZ-së dhe persona të tjerë si kryetar të qyteteve. Këto akuzohen për parregullsi zgjedhore dhe financim të këtyre parregullsive.

Duke përdorur pozitën e tyre dhe dëshirën e madhe për të mbajtur privilegjet që u mundësoheshin duke qëndruar në qeveri, krijuan një grup i cili për qëllim kishte kryerjen e disa veprave penale kundër zgjedhjeve. Këto persona më vonë do të përfshijnë edhe persona të tjerë të cilët do t'u ndihmojnë në realizimin e qëllimit të tyre. Veprat penale të cilat i realizuan këto persona cënoshin Kodin Penal kundër zgjedhjeve dhe votimit, dhe atë kryesisht neni 159- Shkelja e së Drejtës Zgjedhore, neni 160- Shkelja e Lirisë së Përcaktimit të Zgjedhjesve, neni 162- Korrupsioni Gjatë Zgjedhjeve dhe Votimit, neni 164- Shkatërrimi i Dokumenteve Zgjedhore, neni 164- Mashtrimi Zgjedhor.

Personat e Ministrisë së Brendshme ndihmuan në lëshimin e 35000 letra njoftimi të personave që nuk ekzistojnë si dhe nxjerrjen e 15000 numrave amë të rinj të cilët nuk ishin të dedikuara për foshnje të lindura, si dhe 60000 kërkesa për shtetas të rinj të Maqedonisë. Personat të cilët kanë punuar në polici dhe komanderët kanë qënë të autorizuar që të mbulojnë vendbanimet e tyre. Ka pasur raste ku prej një banese të vogël kanë qënë 100 persona me letërnjoftimi me adresë dhe kanë votuar sikur kanë qënë prej atij vendi, a këto persona nuk mundet të kenë jetuar në atë adresë dhe nuk ka mundësi të jenë prej atij vendi. Si dënim për këtë vepër penale mund të dënohen deri në 3 vjet, gjë e cila edhe ka bërë që shumë persona të përfshirë të fshehin veprimin e tyre duke refuzuar se kanë qënë pjesëmarrës në kryerjen e kësaj vepre.

Duhet të cekim se kjo vepër penale me vet fotografimin e letrave të njoftimit tregon se sistemi i mbrendshëm nuk është fare i sigurt në shtetin tonë, lëshimi i letrave të njoftimit, futja e këtyre personave në listat e votimit, paraqitja e këtyre personave në vendvotimet dhe votimi i tyre edhe pse disa as nuk kanë ekzistura më parë. Kjo lëndë ka qënë lënda më e

zgjerruar e mashtrimeve në shtetin tonë pasi ajo është e lidhur dhe e ndërlidhur me kryerjen e shumë veprave penale dhe përfshirjen e shumë institucioneve shtetërore dhe përfshirjen e shumë personave me fuqinë që i autorizon puna e tyre. Si i dëshuar i drejtpërdrejtë ka qënë edhe kryetari i komunës së Pustecit në Republikën e Shqipërisë, Edmond Temelko i cili ka mbledhur shumë persona nga Republika e Shqipërisë për të votuar në shtetin maqedonas sikur ato janë shtetas të Maqedonisë.

Formimi i Prokurorisë Speciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut ndihmonte sado pak në atë kohë që të zbuloheshin këto veprime të kundërligjshme kundër zgjedhjeve. Si gjyqtarë të SJO ishin Katica Janeva - kryetare, Fatime Fetaj dhe Lence Ristovska. Lëndë e parë e kësaj Prokurorie ishte lënda Titanik në Aspektin veprave penale kundër zgjedhjeve.

Si parregullësi të zgjedhjeve të vitit 2012, Katica Janeva ngriti dyshime dhe kundër anëtarëve të KSHZ-së në Çair në bazë të dyshimit se kanë kryer vepra penale “ Mashtrim Zgjedhor” dhe atë duke i ndryshuar rezultatet përfundimtare.

2.3. Modelet zgjedhore sot dhe ndër vite në RMV

Modelet zgjedhore në RMV është i përcaktuara me Kodin Zgjedhore, ku përcaktohen:

Në përgjithësi, në teorinë dhe praktikën e zgjedhjeve janë të njohur dy modele zgjedhore, dhe atë modeli i shumicës (mashhoritar) dhe modeli proporcional dhe më vonë edhe modeli i kombinuar (i përzier) zgjedhor si dhe disa nëntipa të dy modelve të para.

Modeli zgjedhor i shumicës (modeli mashhoritar)- modeli i shumicës paraqitet në dy variante, edhe atë: *modeli i shumicës relative (modeli plural i zgjedhor) dhe modeli i shumicës absolute* ku, dallohen dy nëntipat e tij, dhe atë: *modeli zgjedhor alternativ dhe modeli me dy raunde të zgjedhjeve (modeli i balotazhit).*²⁰

Zgjedhja e kryetarit ose presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut bëhet në vetë territorin e shtetit dhe sipas modelit të shumicës në formë të një njësie zgjedhore. Zgjedhjet bëhen të lira, të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta në të njëjtën kohë në të gjithë

²⁰Каркамишева, Др., Тања, Избори и изборни системи, Скопје, 2004, стр.62

teritorin e Republikës, me votim të fshehtë. Mandati i presidentit të Republikës zgjat 5 vjet me të drejtën që të zgjidhet më së shumti dy herë.

Kandidat për President të Republikës mund të propozojnë së paku 10.000 zgjedhës ose së paku 30 deputetë. Postin e Presidentit të Republikës e mer ai kandidat i cili fiton shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i votuesve. Nëse në rrethin e parë asnjë kandidat për president nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, në rrethin e dytë votohet për dy kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë fituar më së shumti vota. Rrethi i dytë i votimit mbahet brenda afatit prej 14 ditësh nga përfundimi i rrethit të parë të votimit. Për president është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave të zgjedhësve të cilët kanë votuar, në qoftë se kanë votuar më shumë se gjysma e zgjedhësve. Në qoftë se edhe në rrethin e dytë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, përsëritet e tërë procedura zgjedhore. Nëse për President të Republikës është propozuar një kandidat, ndërsa në rrethin e parë të votimit nuk e ka fituar shumicën e nevojshme të votave, përsëritet e tërë procedura zgjedhore. Zgjedhja e presidentit të Republikës bëhet në 60 ditët e fundit të mandatit të presidentit të mëparshëm. Në rast të pushimit të mandatit të presidentit të Republikës nga cilat do qoftë shkaqe, zgjedhja e presidentit të ri bëhet brenda afatit prej 40 ditësh nga dita e pushimit të mandatit. Para marrjes së detyrës, presidenti i Republikës bën deklaratë solemne para Kuvendit me të cilën obligohet në respektimin e Kushtetutës dhe ligjeve.²¹

Modeli zgjedhor proporcional –mundëson ndarjen e mandateve midis partive politike varësisht nga numri i votave të fituara në njësinë zgjedhore. Ky model mundëson përfaqësimin e partive politike varësisht nga numri i përgjithshëm i votave të fituara. Në teorinë dhe praktikën zgjedhore, hasen dy nënlojë të modeleve proporcionale, dhe atë :*modele gjysëm proporcionale dhe modele të pastra proporcionale*.²²

Zgjedhjet për deputet në teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut bëhet sipas modelit proporcional dhe atë zgjidhen 120 deri në 140 deputetë, prej të cilëve 120 deputetë, me ç'rast territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut ndahet në gjashtë njësi zgjedhore të përcaktuara me këtë kod dhe në secilën zgjidhen nga 20 deputetë dhe tri deputetë zgjidhen sipas modelit të shumicës në rrethin e parë të zgjedhjeve dhe atë nga një deputet nga tri njësitë zgjedhore. Deputetët zgjidhen në zgjedhje të lira, të drejtpërdrejta me votim të fshehtë.

²¹<https://www.mod.gov.mk/storage/2022/02/Vendim-per-shpalljen-e-Kushtetutes-se-Republikes-se-Maqedonise-17-nentor-1991.pdf>

²² E drejta Kushtetuese, Dr. Jeton Shasivari, Shkup, 2015

Deputetët zgjidhen nga ana e qytetarëve dhe si të tillë në parlament mbrojnë të drejtat e tyre. Kanë të drejtën e imunitetit dhe mbrohen me ligj dhe kushtetutë. Mandati i deputetëve është 4 vjet me të drejtë për rizgjedhje. Parlamenti verifikon mandatin e tyre. Mandati i deputetëve në Kuvend mund të zgjatet vetëm në rastë të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme. Me ligj caktohet papajtueshmëria dhe pazgjedhshmëria e funksionit të deputetit në Kuvend me ushtrimin e funksioneve ose profesioneve të tjera publike. Kuvendi shpërndahet nëse për atë deklarohet shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve

Zgjedhja e kryetarit të komunës bëhet në rajonin e komunës, si dhe në qytetin e Shkupit sipas modelit të shumicës të cilat mbahen çdo katër vjet, njëkohësisht në të gjitha njesitë, në gjysmën e dytë të tetorit dhe kryetari i kuvendit i shpall zgjedhjet me akt perkates i cili publikohet në “Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë Veriut”, ndërsa nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në mbajtjen e zgjedhjeve nuk mund të kalojnë më shumë se 90 e më pak se 70 dite, ku sipas modelit zgjedhor përdoret modeli mazhoritar ku për kryetar komune zgjidhet kandidati që ka fituar shumicën e votave në raundin e parë të votimit nëse dalin së paku një e treta e zgjedhësve të regjistruar në Listën zgjedhore të njesisë perkatese të vetëqeverisjes lokale por, nëse asnjëri nga kandidatet nuk i plotëson kushtet e kerkuara, zgjedhjet perseriten në raundin e dytë për dy kandidatet që kanë marrë më shumë vota dhe në zgjedhje merr pjesë vetëm një kandidat dhe ai nuk fiton shumicën e kerkuar procedura e zgjedhjes perseritet kurse raundi i dytë i zhvillohet 14 dite pas përfundimit të të parit dhe në raundin e dytë zgjidhet kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave.²³

Metoda e D’hontit është metodë e cila paraqet modelin e herësit më të madh zgjedhor, që ka për qëllim menjëherë mangësitë të modelit paraprak në nivel të njesisë zgjedhore. Ky model është themeluar nga juristi belg Viktor Dhont dhe zbatohet në pjesë dërmuese në Evropë dhe shtete të tranzicionit²⁴. Sipas kësaj formule, numri i përgjithshëm i votave të fituara për listat e propozuara të kandidatëve pjesëtohet me serinë e pjesëtuesve 1, 2, 3... deri në numrin e anëtarëve të këshillit që zgjidhen në njësinë specifike të vetëqeverisjes lokale dhe kuotat e mara në këtë mënyrë renditen sipas madhësisë, duke marrë parasysh koeficientët më të mëdhenj sa janë zgjedhur anëtarë të këshillit dhe një listë e kandidatëve merr aq antarë këshilli sa ka kuotat më të mëdha nga ato që konsiderohen.

²³ Per më tepër shih në: Kodi zgjedhor I RMV-se, Dispozita Themelore, “Sluzben vesnik na Republika Makedonija”, Faq.28-Nr.40, Neni 3.modeli Zgjedhor

²⁴ Për më tepër mbi metodën e D’hontit shih në: jeton Shazivari, E drejta kushtetuese, Furkan-ISM, Shkup, 2020, faq.285-288

Modeli zgjedhor i kombinuar(i përzier) -është i ngjajshëm me modelin paralele si model gjysmë proporcional, ku poashtu kemi kombinimin e modelit proporcional të votimit të listave partiake me modelin e shumicës (mazhoritar) ku “fituesi i mer të gjitha”, mirëpo dallimi kryesor midis këtyre dy modelve konsiston në faktin se, modeli i kombinuar i përkufizuar si një model i kombinuar (përzierjes) të modelit proporcional me atë të shumicës, e kompenson përshpejtimin përfaqësues në suaza të njësisive mazhoritare zgjedhore, gjë që nuk arrin të bëjë modeli paralel.²⁵

2.3.1 Llojet e zgjedhjeve

Zgjedhjet dhe sistemi zgjedhor

Republika e Maqedonisë së Veriut u nda nga ish-Jugosllavia dhe u bë shtet sovran dhe i pamvarur me vitin 1990. Si shtet sovran qytetarët formuan partitë e tyre politike dhe po në vitin 1990 mbahen edhe zgjedhjet e para të lira, shumëpartike dhe demokratike. Kemi zgjedhje për deputetë të Republikës, pra zgjedhje parlamentare, zgjedhje për kryetar të Republikës dhe zgjedhje për këshilltarë dhe kryetarë të komunave, pra zgjedhje lokale.

Zgjedhje Parlamentare

Në RMV janë mbajtur gjashtë herë zgjedhje të rregullta parlamentare dhe katër zgjedhje të parakohshme parlamentare në vitet 2008, 2011, 2014 dhe 2016 të cilat janë të rregulluara me ligj dhe Kushtetutën e Republikës. Në shtetin tonë zgjidhen 120 deri në 140 deputet në 6 njësi zgjedhore në zgjedhje të lira dhe të barabarta. Deputetët e zgjedhur nga qytetarët duhet të punojnë në interes dhe në kërkesë të po këtyre qytetarëve. Popullatat pasi shpall pakënaqësi në momentin e sjelljes të një ligji ose të ndonjë vendimi të madh nga ana e përfaqësuesve parlamentar, qytetarët revoltin e shprehin me anë të deputetëve të zgjedhur. Pra, deputetët janë zëri i popullatës që ato i kanë zgjedhur.

Zgjedhje Presidenciale

Në historin e RMV-së ka pasur dy mënyra në zgjedhjen e presidentit të republikës dhe atë presidenti i parë, Kire Gligorov është zgjedhur në parlament me votimin e deputetëve në

²⁵Каркамишева, Др., Тања, Избори и изборни системи, Скопје, 2004, стр.97

përputhje me vendimet Kushtetuese të atëherëshme, por me ndrimin e kushtetutës më pas presidentët e tjerë janë zgjedhur në zgjedhje të lira dhe demokratike në të gjithë teritorin e shtetit tonë. Deri sot janë mbajtur gjashtë herë zgjedhje për president. Në aspektin ligjor kryetari i shteti është i detyruar që ta prezantojë shtetin tonë në mënyrë të denjë dhe korrekte. Ndër detyrat kryesore të kryetarit të shtetit vlen momenti i sjelljes së një dekreti i cili edhe nëse presidenti nuk është dakord nëse e votojnë dy të tretat e deputetëve ai është i detyruar që ta nënshkruajë.

Zgjedhje Lokale

Zgjedhjet lokale pasqyrojnë zgjedhjen për kryetar të komunës ku jetojmë, e cila përmban një peshë të madhe. Poashtu, në të njëjtën kohë votojmë edhe për këshilltarë të komunës përkatëse. Deri sot janë mbajtur shtatë herë zgjedhje lokale. Zgjedhjet lokale luajnë një rol tejet të rëndësishëm për popullatën sepse aty zgjidhen persona të cilët janë më të afërt me personat e atij vendi me problemet e tyre me ankesat e tyre. Këto persona të gjitha kënaqësit dhe pakënaqësit i shprehin te këshilltarët të cilët zgjidhen nga rrethi i personave të qytetit përkatës, ku më pas puna e këtyre këshilltarëve është që këto raporte t'i paraqesë para seancës së caktuar të komunës. Një këshilltar duhet të punojë dyfish nëse dëshiron të zgjidhet prap për këshilltar, sepse ai suksesin ose dështimin e punës së tij e paraqet pikëpikë për familjes së ngushtë e më pas asaj të gjërë.

2.3.3 Evidencat statistikore të marra nga organet qeveritare dhe joqeveritare gjatë zgjedhjeve

Ne këtë kapitull do të përshkruajmë organizatat qeveritare si dhe ato joqeveritare të cilat përmbajnë të dhëna statistikore për mbajtjen e zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke filluar prej ditës së pavarësisë e deri në zgjedhjet e fundit:

KSHZ-ja (Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve)

Për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të fshehta, të barabarta, garantimi i votës së lirë dhe universale dhe të drejtpërdrejtë duhet të kemi një institucion i cili e bën këtë punë në mënyrë

efikase dhe të pagabueshme. Për këtë arsye është formuar KSHZ-ja (Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve). Misioni dhe vizioni i saj përmbahet në principet që sa po i përmendëm ku në kryerjen e punës së tyre përmbahen në të drejtën, ligjin, aktete nënligjore, kodin zgjedhor dhe kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky plan strategjik është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta dhe një procesi të gjatë të konsultimit me shërbimin profesional dhe të gjitha organet e tjera zgjedhore, duke përfshirë sygjerime nga më shumë institucione vendore dhe ndërkombëtare, si dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR-it.²⁶

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) përbëhet nga shtatë anëtarët dhe atë kryetari, zëvendësi i tij dhe 5 anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të numrit të përgjithshëm të deputetëve, ndërsa mandati i antarëve zgjat nga dita e zgjedhjes nga Kuvendi deri në zgjedhjen e përbërjes së re të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, por jo më gjatë se dy vjet dhe Kuvendi shpall zgjedhjen e antarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në “Gazetën Zyrtare” dhe në shtypin ditor ku shpallja zgjat tetë ditë nga dita e publikimit²⁷

Në kryerjen e punës sa më efikase kjo organizat mundohet që në mbajtjen e zgjedhje të përfshihen teknologjitë më të reja dhe efikase të cilat do të lehtësojnë edhe vetë procesin zgjedhor, por edhe do të mbrojnë nga parregullsitë e shumta gjatë procesit zgjedhorë.

Për të pasur një punë sa më efikase KSHZ-ja duhet të jetë edhe transparente ndaj qytetarëve në pikë të parë sepse mbron të drejtën dhe votën e tyre. Kjo organizatë duhet të jetë e hapur me publikun duke informuar atë dhe pjesëmarrësit për procesin zgjedhor, faqen e uebit, mediat sociale dhe mediat e drejtpërdrejta kur do të jetë nevoja.

Raporte e saja të cilat përshkruajnë rjedhojën e mbajtjes së një procesi zgjedhor meren si të sakta dhe dorëzohen në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe publikohen në faqen e internetit në afat sa më të shkurtër. Rezultatet e punës të palodhshme të antarëve të KSHZ-së merren edhe si bazë dhe shpallet fituesi në zgjedhje.

Antarët e KSHZ-së, të punësuarit e kësaj organizate janë persona të paanëshëm në zgjedhje dhe vetë pesha e punës së tyre tregon se ato janë të vetëdijëshme për rëndësinë që sjell rezultati i punës së tyre.

²⁶ <https://www.sec.mk/sq/misioni-dhe-vizioni-i-komisionit-shteteror-te-zgjedhjeve/>

²⁷ Për më tepër për organet për realizimin e zgjedhjeve locale shih në: Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров, Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година, Второ дополнето издание, декември 2021, КАС, Скопје, стр.38-39

KKZ-ja (Komisioni Komunal i Zgjedhjeve)

Në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut formohen gjithsej 80 komisioni komunale zgjedhore si organe zgjedhore të përherëshme. Organet që e përbëjnë janë kryetari, katër anëtarë dhe zëvendësuesit e tyre. Zgjedhja e tyre kryhet nëpërmjet zgjedhjes së rastësishme nga radhët e të punësuarëve në administratën shtetërore, komunale dhe administratën e qytetit të Shkupit, me arsime lartë në kohëzgjatje prej pesë vitesh.

Antarët e KKZ-së dhe bordet zgjedhore nuk mund të zgjidhen apo emërohen nga zyrtarët e Qeverisë, Kuvendit dhe personat e punësuar në administratën shtetërore të Avokatit të Popullit, Ministrisë së Drejtësisë, Mbrojtjes, Punëve të Brendshme, Sekretariatit për Legjislacion, Entit Shtetëror të Statistikave, KSHZ-së, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.²⁸ KKZ-ja ka sekretar dhe zëvendës të tij. Sekretarin dhe zëvendësin e tij e emëron kryetari i KKZ-së nga radha e juristëve të diplomuar për kohëzgjatje prej pesë vitesh.

Për çdo komunë formohet KKZ e veçantë. KKZ-ja është përgjegjëse për zbatimin e veprimeve zgjedhore në komunë dhe vendvotimet e përcaktuara me Kodin Zgjedhor, respektivisht në territorin e komunës për të cilën është formuar KKZ-ja.

Këshilli Zgjedhor

Këshilli zgjedhor është organ që formohet për çdo qendërvotimi, përbëhet nga pesë anëtarë, njëri prej të cilëve është kryetari dhe për secilin prej tyre zgjidhen deputetët. Kryetari i Këshillit Zgjedhor dhe zëvendësi i ri, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga radhët e të punësuarëve në shtet, publik, komunal dhe administratën e Qytetit të Shkupit, me arsim të mesëm së paku të përfunduar, në mënyrë të rastësishme për një periudhë prej katër vitesh. Një anëtar i KZ-së dhe zëvendësi i tij emërohen me propozimin e partive politike në opozitë që kanë fituar më shumë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe një tjetër me propozimin e partive politike në pushtet që kanë fituar më shumë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare.

Zgjedhjet e rastësishme të anëtarëve të këshillave zgjedhorë (nga radhët e administratës) e bëjnë KKZ-të për zonën për të cilën janë kompetente, sipas aktit të

²⁸ Për më tepër për organet për realizimin e zgjedhjeve locale shih në: Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров, Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година, Второ дополнето издание, декември 2021, КАС, Скопје, стр.38-39

mëparshëm të KSHZ-së, ndërsa në ato komuna ku jetojnë së paku 20% e qytetarëve, pjestarë të komuniteteve joshumicë, zbatohet parimi i përfaqësimit adekuat dhe të drejtë në përbërjen e KKZ-ve dhe Këshillave Zgjedhor. Ligji parashikon gjithashtu një përfaqësimit adekuat dhe të drejtë në përbërjen e KKZ-ve dhe Këshillave Zgjedhor. Ligji parashikon gjithashtu një përfaqësimit prej së paktën 30% të secilës gjini në përbërjen e organeve zgjedhore.

OSBE (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë)

Sistemi zgjedhor, ligjet si dhe korniza ligjore për mbajtjen e zgjedhjeve është e përcaktuar nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, por ndër vite ka pasur ndryshime. Këto ndryshime kanë ardhur edhe nga sygjerimet dhe rekomandimet paraprake të OSBE/ODIHR-it dhe ndryshimet e fundit janë bërë në vitin 2014 dhe normal këto ndryshime janë benefite dhe në favor të të drejtave të popullatës. Edhe pse nuk është praktikë e mirë të ndryshohen elementet themelore të kornizës ligjore brenda më pak se një viti para zgjedhjeve, ndryshimet e fundit janë miratuar me konsensus ndërpartiak.²⁹

Ndër ligjet të cilat kanë pasur ndryshime kanë qënë ligjet për financimin e partive politike gjatë zgjedhjeve, afatet për vendimet e gjykatave për të drejtata e mediave si dhe korrupsionit gjatë zgjedhjeve. Këto rekomandime kanë ndihmuar në precizimin e ligjeve në këto dukuri.

OSBE/ODIHR-i gjatë zgjedhjeve vepron nëpërmjet anëtareve të sajë vëzhgues. Vëzhguesit kanë të drejtë të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës dhe ato mbrohen me ligj dhe askush nuk mund t'ua ndalojë atë. Ato bashkëpunojnë me Komisionin Zgjedhor si dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme që puna e tyre mos pengojë gjatë zgjedhjeve, por në të njëjtën kohë vëzhguesit marrin të dhëna dhe shkruajnë raport në atë se çfarë ndodh në një vendvotim. Parregullsitë por edhe rregullsitë e mbajtjes së zgjedhjeve përshkruhen në raportet e vëzhguesve të kësaj organizate.

Raportet e kësaj organizate joqeveritare, por edhe të organizatave tjera janë ato të cilat edhe i japin një pasqyrim ecjes së mbajtjes së zgjedhjeve dhe në atë se sa respektohet e drejta e votës së lirë dhe e barabartë për të gjithë.

²⁹ Komisionit i Venedikut i Këshillit të Evropës, në Kodin e praktikës së mire të çështjeve zgjedhore, Paragrafi 2.2, rekomandon që "elementet thelbësore të ligjit zgjedhor, veçanërisht sistemi zgjedhor, anëtarësimi në komisionet zgjedhore dhe përcaktimi i kufijve të njësive zgjedhore, nuk duhet të ndryshohen në periudhë më të shkurtër se një vit para zgjedhjeve".

MOST (organizatë qytetare)

Organizata joqeveritare MOST është një organizatë e brendshme, joqeveritare, jo partiake dhe e asnjëanëshme e formuar në vitin 2002 dhe e përfaqësuar nga 20 përfaqësues nga i gjithë territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo organizatë njihet nga paanshmëria, besueshmëria, profesionalizmi dhe menaxhimi i mirë.

Qytetarët e ndërgjegjshëm dhe aktiv e paraqesin këtë organizat shumë të organizuar e cila nga ana tjetër është edhe bazë për ndërtimin e qëndrueshmërisë dhe demokracisë në teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

MOST punon në inkurajimin e qytetarëve dhe mobilizimin e tyre për t'i shfrytëzuar të drejtat e tyre e për të forcuar kulturën demokratike në rajonin duke rritur kapacitetin demokratik të organizatave të shoqërisë civile, institucioneve dhe aktorëve politike, përmes krijimit të partneritetve të qëndrueshme. Kjo organizatë inkurajon dhe mobilizon qytetarët që të bëhen pjesëmarrës aktiv në demokracinë në nivel shtetëror dhe lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i kësaj organizate është që të mbështesë përpjekjet dhe të organizojë aktivitete për reformimin e institucioneve dhe proceseve për t'i bërë ato më të përgjegjshme, transparente dhe të hapura ndaj nevojave të qytetarëve. Te forcohet kapaciteti i shoqërisë civile në menyre që t'i mundësohet zëri dhe hapësira për veprim civil mbi një bazë të qëndrueshme

CIVIL –AXIOS 2017 Shkup

Kjo është shoqatë organizatë nacionale qytetare jopërfituese e qytetarëve në fushën e të drejtave të njeriut, paqe dhe kontrollit të armëve, e themeluar më 25 nëntor të vitit 1990. Joformalisht, organizata është aktive nga viti 1996.

Vëzhgimin e saj zgjedhor e praktikon nga viti 2008 duke vendosuar dhe avancuar edhe metoda të reja dhe më efektive të vëzhgimit dhe edukimit qytetar për të drejtat votuese, metoda unike dhe gjithëpërfshirëse. Operon në nivel rajonal dhe ndërkombëtar dhe ka zbatuar mbi 100 projekte. Vizionet e kësaj organizate janë :

- një botë në të cilën të gjithë njerëzit jetojnë në shoqëri të qetë demokratike³⁰
- promovimi aktiv dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, paqes së qëndrueshme dhe proceset e pajtimit
- krijimi i planeve për kontrollin efektiv të armëve
- drejtësi socioale dhe liria e shprehjes³¹
- kundër diskriminimit dhe shovinizmit në cilindo formë

Organizata Civil është organizata më e zgjeruar në teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe si e tillë është e pranishme në të gjitha sferat e lartpërmenduar. Kjo organizatë sulmon bindshëm Qeverinë, punën e saj e sidomos konceptin e Qeverisë për demokracinë. Më 12 prill të vitit 2016 u ngrit edhe njëra nga protestat më të mëdha në vend kundër pushtetit të atëherëshëm ku organizimi vinte nga po kjo organizatë, dhe më vonë iu bashkangjiten edhe partitë e tjera joqeveritare.

Ajo protestë u quajt Revolucioni i Larmë dhe si synim kryesor kishte të drejtën dhe lirinë e njeriut, gjë e cila ishte e kontrolluar dhe e kufizuar nga partitë qeveritare. Kjo protest është e shënuar si edhe protesta më e gjatë e cila zgjati ditë dhe muaj me radhe duke ecur nëpër rrugët e gjithë qyteteve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Edhe sot e kësaj dite kjo organizatë lufton bindshëm ndaj instrumenteve të Qeverisë të cilat çenojnë demokracinë në shtet, por një fuqi edhe më të madhe kritikuese e ka në kohën e mbajtjes së zgjedhjeve ,në të cilën në mënyrë haptasi çënohen e drejta e lirë dhe e barabartë e votuesve.


Evidenca statistikore

Nëse bazohemi në evidencat statistikore të procese zgjedhore të mbajtura ne Republikën e Maqedonisë së Veriut, çdo herë si bazë ose si rezultate përfundimtare do të marrë rezultatet të cilat vijnë nga raportet e përfunduara të **KSHZ-së (Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve)**, nga vetë fakti se ky organ është organ institucional shtetëror. Por, KSHZ-ja nuk funksionin vetë duke nënkuptuar se edhe organet tjera, si ato qeveritare edhe ato joqeveritare ndihmojnë në raportet përfundimtare.

³⁰ <https://civilmedia.mk/wp-content/uploads/elections-AL-01.pdf>


³¹ <https://www.civil.org.mk/per-ne/?lang=sq>

Rezultatet zgjedhore për zgjedhje parlamentare



Kjo tabelë është e plotësuar sipas të dhënave të KSHZ-së e cila edhe është organizat ose institucion qeveritare dhe e cila e shpall fituesin duke u bazuar në të dhënat e mbledhura. Duke hecur nëpër historinë e shqiptarëve kjo tabelë paraqet vetëm një pasqyrë të malltretimeve dhe vuajtjeve po të shqiptarëve dhe pakicave tjera në shtetin tonë. Edhe pse në kohën e formimit të pavarësisë, e vetmja mbikqyrje e jashtme e zgjedhjeve ishte mbikqyrja ndërkombëtare, në atë kohë nuk merreshin parasysh raportet zgjedhore të tyre në aspektin e ndryshimit, por vazhdoheshte në vijën e njëjtë. Pasi u bën shumë ndryshime në vendin tonë, duke përmendur edhe luftën e 2001, rrjedhojat për një kohë të shkurtur filluan të ndryshojnë, ndoshta në një vijë shumë të shkurtur, por prap së prapë sadopak kishte shpresë edhe për shqiptarët në aspektet e punësimit, arsimimit dhe strukturave të tjera. Shumë vepra të kundërligjshme kanë ndodhur ndër vite në proceset e mbajtjes së zgjedhjeve, por edhe vetë kallzimet e tyre në organet përkatëse nuk kanë mundur të ndalojnë shpalljen e fituesit, por ato janë zvarritur nëpër seanca të njëpasnjëshme dhe asgjë s'ka ndryshuar. Me formimin e organizatës Civil dhe MOST raportet e tyre sadopak kanë ndihmuar në ngritje e zërave në pakënaqësit e popullit.


Rezultatet zgjedhore për zgjedhje presidenciale



Në këtë skemë do të paraqesim partitë që fituan zgjedhjet, por mos harojmë se këto parti nuk mund të formonin qeveri pa formuar koalicion dhe atë në të gjitha rastet me partit shqiptare. Edhe pse ato asnjëherë nuk pranuan se fal koalicionit me partit shqiptare aritën të qëndrojnë në opozitë, vazhdonin të punojnë, por kundër palës shqiptare gati në çdo aspekt që mundeshin. Shumë ngjarje kanë ndodhur në këto vite ku shpresa e palës shqiptare nuk shueshte edhe pse dita ditës ato shpresa u humbeshin.

Në të shumtën e rasteve sidomos në dy rastet e fundit, pakënaqësit për kandidatët e prezantuar, popullata e gjërë e shprehte duke mos marrë pjesë në zgjedhje, sidomos në vitin 2014 ku fitoi kandidati maqedonas Gjorgji Ivanov. Por si në të shumtën e rasteve të pasqaruar prap së prapë ky kandidat u shpall për president me mandat të plotëfuqishëm.

Rezultatet zgjedhore për zgjedhje komunale



Si një organizatë joqeveritare ma me zë mundet të merret organizatën MOST(organizatë qytetare), e cila njihet nga paanshmëria e saj, besueshmëria, profesionalizmi. Kjo organizatë ndjek zgjedhjet dhe shpreh pakënaqësit e saja në konferencat e saja për shtyp, si dhe bën denoncime ose kallzime penale në institucionet përkatëse. Gjithashtu, paraqet edhe një numër telefoni në të cilën qytetarët mundin të paraqesin pakënaqësitë ose parregullsitë gjatë mbajtjes së procesit zgjedhor. Duke bërë këto kallzime ajo ngjall edhe një besueshmëri tek popullata e gjërë e cila ndihmon edhe në ngjalljen e një shprese se e drejta e tyre do të vlerësohet dhe ngjall shpresën tek popullata e cila nuk dëshiron të votojë sepse beson se e drejta e tyre e votës keqpërdoret.

Një rast i cili vlen të përmendet, janë zgjedhjet e vitit 2016 ku kjo organizata fliste bujshëm se listat e zgjedhjeve nuk janë të plotësuara, nuk janë të pastruara nga personat që nuk jetojnë më si dhe janë të mbingarukuar nga personat që nuk ekzistojnë në Maqedoni dhe si rezultat ato kërkonin që të punoeshte edhe pak me listat, sepse sipas tyre nuk kishte kushte për mbajtjen e zgjedhjeve. Por nëse flasim për zgjedhjet e vitit 2019 kjo organizat mbështete raportet finale dhe konstatoj se përherë të parë janë aritur mbajtja e zgjedhjeve korekte dhe të sigurta.

Si përfaqësues ndërkombëtar OSBE/ODIHR-it kanë të drejtën e tyre të paraqesin pakënaqësit gjatë proceseve zgjedhore. Ndër vite ato kanë theksuar se zgjedhjet dhe mbajtja e procesit zgjedhor ka ndryshuar ndër vite dhe vlen të theksohet se asnjë proces zgjedhor nuk ka qënë i njëjt me tjetrin. Vërejtjet e tyre gjithmonë janë përqëndruar në regjistrimin e votuesve, regjistrimin e kandidatëve, dita e zgjedhjeve, dita më pas dhe shqyrtimi dhe rishqyrtimi i ankesave dhe mbrojtja e lirisë për të votuar. Një ndër synimet kryesore mbetet ndalimi i keqpërdorimit të votës së lirë.

KAPITULLI I TRETË

3. RAPORTI MES KRYERËSIT DHE VEPRA PENALE

Kriminaliteti në tërësi, së këndejmi edhe disa lloje të kriminalitetit në veçanti, nuk mund të shpjegohen në tërë kompleksitetin e tyre pa u studiuar dhe ndriçuar edhe disa karakteristika themelore personale dhe sociale të këtyre sjelljeve, nga se kriminaliteti si dukuri e përgjithshme manifestohet përmes kryerjes së veprave penale konkrete.³²

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut çdo qytetar i cili ka mbushur moshën madhore d.m.th 18 vjet fiton të drejtë të votojë, të jetë pjesëmarrës në zgjedhje dhe përmes votës të shprehë dëshirën dhe vullnetin e tij të lirë. E drejta e votës është e barabrtë, e përgjithshme dhe e fshehtë. Çdo shkelje e këtij veprimi çon në veprim të kundërligjshëm, pra në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë kemi të bëjmë me vepër penale.

Kryerësi i veprës penale edhe pse di rregullat kyesore ai vepron në kundërshtim me ligjin dhe e paraqet veten si kryerës i veprës penale. Raporti midis kryerësit dhe veprës penale është shumë i ngushtë sepse rrjedh nga vetë ai, nga vetë marrja e veprimeve të cilat ai është i vetëdijshëm që i kryen.

Kryerës të veprave penale kundër zgjedhjeve janë persona të thjeshtë të cilët për ndonjë arsye vendosin t'i dalin në kundërshtim rregullave zgjedhore, duke përdorur forcën, logjikën të mirat materiale. Ndodh që në disa situata kryes të veprës penale munden të jenë edhe persona zyrtar të cilët përdorin pozicionin e tyre dhe të mirat materiale të cilat ua mundëson pozicioni i tyre dhe dalin në kundërshtim me ligjin.

Personat zyrtar janë të përfshirë në shumë segmente të mira të jetës, të përfshirë në pushtetin politik, ekonomik, financiar, gjyqësor dhe segmente të tjera, të cilat kanë autoritet për të shfytëzuar pozita të larta shtetërore dhe me keqpërdorimin e pozitës së tyre kryejnë vepra penale duke u involvuar në kriminalitet, ose të ashtuquajtur kriminal të jakës së bardhë me status të lartë shtetëror.

Kriminalitetin zgjedhor e përdorin personat zyrtar, por veprimet e tyre kryhen nga personat e thjeshtë të cilët për ndonjë arsye, qëllimi apo synimi me zgjedhjet parapraka

³²Mihajlo Ačimović, Pravci Kriminalne Psihologije, (Beograd, 1976) në 7 – 8.

plotësojnë kërkesat e tyre dhe me këtë i plotësojnë në të njëjtën kohë edhe dëshirat e tyre personale.

3.1 PARANDALIMI

Policia

Është një organ i përbërë prej personave të autorizuar në një shtet, me qëllim të zbatimit të ligjit, të garantojë sigurinë, shëndetin dhe të parandalojë krimin në shtet. Ato kanë të drejtë që nëse nuhasin në kryerjen e një veprë penale d.m.th një veprë kundër ligjit atëherë ato kanë të drejtën e arrestimit dhe përdorimin e forcës të përfshirë në suazat e ligjit. Në një proces zgjedhor, policia ndihmon në shumë aspekte, ruajtjen e materialit zgjedhor, ruajtjen e materialit zgjedhor deri në momentin e dorëzimit të tij të gjithë këshillave zgjedhorë nën kompetencë të KKZ-së, sigurimin e vendvotimeve (prej orës 06:00 deri në 19:00), ndërhyrjen në ndonjë parregullsi ose sjellje të kundërligjshme. Kjo ndihmon sidomos kur një person shkon të votojë me vetë prezencën e policisë si qytetar ndihet i sigurtë në dhënien e votës së tij, pa asnjë presion ose tension nga persona tjerë.

Rol gjithashtu shumë të rëndësishme luan në momentin e numërimit të votave ku anëtarët e KSHZ-së janë më të sigurtë nga ndonjë prezencë e padëshiruar ose nga presione të jashtme, kërcënime të cilat mundet të vijnë si dhe sigurimin e anëtarëve të KZ-së deri në dorëzimin e procesverbaleve dhe materialeve të tjera deri te komisioni komunal zgjedhor.

Roli i Prokurorisë Publike

Edhe pse vetë ligji i zgjedhjeve ndërthur në vete nene kundër veprave penale të zgjedhjeve, qytetarët e thjeshtë kanë një frikë në paraqitjen e ankesës në momentin që u cenohet vota e lirë dhe demokratike. Në shtetin tonë ekzistojnë institucione ku mundet të ankimohet kundër pakënaqësive dhe veprave të kundërligjshme gjatë procesit zgjedhor. Këtu vëndohet në përdorim prokuroria publike dhe puna e saj për t'i zgjidhur këto ankesa dhe për t'ua shqiptuar dënimin përkatës.

Ankesat munden të jenë gjatë procesit zgjedhor, në keqpërdorimin e burimeve administrative, keqpërdorimin e materijaleve, cënimin e votimit, por edhe në rezultatet përfundimtare ku edhe munden të bëjnë parregullsi.

Shqiptimi i masës

Në një proces zgjedhor kryerja e një vepre të kundërligjshme vë në lëvizje shumë institucione shtetërore. Nëse një person kryen një vepër penale kundët të njëjtit bëhet kallëzim penal, pastaj i cënohet e drejta e lirë nga policia e cila pasi e arreston e çon në paraburgim, dhe lajmëron prokurorin publik që t'i shqiptohet masa e arrestimit dhe për të vazhduar më tej me lëndën e tij.

Prej momentit të arrestimit dhe paraqitjes para gjykimit shqiptimi i masës së paraburgimit prej 30 ditësh, personi qëndron në burgum e qytetit ku është arrestuar e më pas vijojnë seancat gjyqësore për shqiptimin e dënimit. Nëse gjatë paraburgimit i tërhiqet kallëzimi penal atëherë mundet i njëjti të lishoet i lirë dhe nuk dënohet.

Roli i gjykatës

Puna e gjykatës është një punë shumë e rëndësishme e cila më pas edhe më vendimtare për vetë faktin sepse cakton fatin e një personi që kryen vepër penale. Këto vendime të gjykatësit mund të zgjasin me ditë dhe muaj, por edhe me vite. Dënimet të cilat më të shumta që u shqiptohen këtyre personave nga ana e gjykatësve janë me burg prej në 6 muaj deri në 3 vjet.

Gjykatësi duke mbajtur rëndësin e peshës së dënimit çdoherë ka të drejtë që të kërkojë prova të shumta si dhe të anulojë një proces gjyqësor sa herë që ai nuk është i sigurtë në intuitën e tij se provat e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të dhënë një dënim.

3.2. Profili i kryerësit dhe të veprave penale

Struktura gjinore

Ndër vite kemi qënë dëshmitarë se veprat penale ose shkeljet ligjore në përgjithësi kryhen nga gjinia mashkullore. Femrat jo që nuk kryejnë vepra penale kundër zgjedhjeve, por nëse shofim statistikën janë më të pakta duke krahasuar meshkujt. Por duke nisur nga disa statistika nëse kemi të bëjmë me persona zyrtarë edhe gjinia femërore është shumë e përfshirë. Nëse femrat kanë ndonjë punë që ua lehtëson kryerjen e veprës penale kundërligjore ato e kryejnë., normal flasim për disa persona jo të gjithë.

Përkatësia etnike

Nëse flasim për shtetin tonë ne kemi të bëjmë me palën maqedonase dhe atë shqiptare. Zgjedhjet janë ato të cilat edhe zgjojnë nacionalizmin e çdo personi dhe për këtë arsye personat politikë gjatë zgjedhjeve e shfrytësojnë në maksimum këtë gjë. Kur hyn nacionalizmi në mes atëherë kryerja e veprave penale kundër zgjedhjeve bëhet nga të dyja anët. Personat zyrtarë janë ato të cilët edhe ua mundësojnë edhe më tepër që të kryejnë këtë kundërligjshmëri. Maqedonasit me fuqinë e tyre ndër vite kanë treguar më shumë forcë gjatë zgjedhjeve dhe ne jemi dëshmitarë se në historinë e zgjedhjeve në shtetin tonë janë malltretuar shumë shqiptarë dhe janë cënuar shumë të drejtata e tyre, sidomos shqiptarë të fshatrave, por në kohën e fundit sa do këto veprime edhe janë dënuar ose janë zbuluar sidomos një numër i vogël i tyre.

Mosha

Mosha është një karakteristikë e rëndësishme e fenomenit kriminal që ka peshë të veçantë në shpjegimin e sjelljeve kriminale.³³Nga vetë të dhënat statistikore shtetërore që i marim dëshmojnë se kryerësit e veprave penale zgjedhore janë persona që u përkasin moshave, gjinive, përkatësisë nacionale dhe nivelit arsimor të ndryshëm. Personat e rritur janë personat të cilët më tepër kryejnë vepra penale të cilët edhe dënohen sipas veprimeve të tyre.

³³ Ragip Halili, Kriminologjia, (Prishtinë, 2000) në 76

Arsimi

Arsimimi sipas mendimit tim ka ndihmuar në ndarjen e personave që e kanë kryer veprën penale duke filluar nga ato të cilët kanë qënë te orientuar nga ato me arsimim dhe paarsimim. Personat e arsimuar janë gjithashtu persona të cilat kryejnë vepra penale kundër zgjedhjeve duke nisur nga puna që e kryejnë, janë të autorizuar nga ajo punë dhe e kanë shumë më të lehtë të kryejnë kundërligjshmëri. Ndërsa nga ana tjetër nëse flasim për persona të paarsimuar kemi të bëjmë me persona që i drejton ose i urdhëron dikush të kryejnë kundërligjshmëri e sidomos kur u premtohet diçka që ato e dëshirojnë në këmbim të votës së tyre.

3.3 Organet në të cilat kryhen vepra penale, keqpëdorimi i pozitës dhe autorizimi zyrtar.

Pjesëmarrës në realizimin ose mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe korekte janë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së, por në veçanti pjesëmarrës janë persona zyrtarë të cilët janë të caktuar në bazë të punës së tyre që të organizojnë zgjedhje korekte.

Autorizimi zyrtar i tyre vjen nga vetë marrëdhënia e punës të cilën ato e posedojnë. Këto persona mbrojnë ligjin dhe kushtetutën, por në të shumtën e rasteve ato mundohen edhe të keqpërdorin pozicionin e tyre duke punuar në kundërshtim me ligjin dhe në favor të ndonjë personi tjetër. Në këtë rast ato kryejnë vepër penale kundër zgjedhjeve.

Persona zyrtar mund të jenë punonjësit e ndërmajeve publike, të punësuar në qeveri si ministra, deputetë ose dhe punëtorë të thjeshtë të cilët kryejnë një punë zyrtare administrative në vetë komunat ku mbahen zgjedhjet, por edhe në suaza më të medha dhe persona me pozicione më të mëdha.

Organet të cilat duhet të merren me ndalimin e kryerjes së veprës penale të zgjedhjeve janë Enti Shtetëror i Revizionit, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Komisioni Zgjedhor. Komisioni Zgjedhor përbëhet nga kryetari, zëvendeskryetari dhe anëtarët e tij. Komisioni zgjedhor ruan reputacionin e një komisioni i pavarur, i paanshëm, profesional dhe i përgjegjshëm në mbajtjen e zgjedhjeve. Ajo përcakton vëzhgues të cilët ndjekin procesin zgjedhor dhe ndihmojnë në zbulimin e kundërligjshmërisë.

Edhe pse organet e autorizuar për mbajtjen e zgjedhje na paraqiten si të paanshme dhe të pavarura ato në vete përmbajn hapsirë dhe fuqinë për të kryer vepra penale dhe mund të cilsohen edhe si personat të cilët lejojnë kryerjen e veprave penale nga mosparaqitja e disa veprimeve si të kundërligjshme.

3.4 Subjektet pjesëmarrës në kryerjen e këtyre veprav penale

Nëse flasim për subjektet kyç pjesëmarrës në kryerjen e veprave penale duhet me nis nga personat të cilët i cekëm më lartë dhe në atë se sa janë të aftë të kordinojnë një proces zgjedhor. Vetëantarët e Komisionit Zgjedhor deklarohen të asnjëanëshëm, por në të vërtet ato mundet të jenë persona të njërës ose tjetrës parti të cilëve u mundësojnë kryerjen e parregullsive gjatë mbajtjes së procesit.

Si subjekte të kryerjes së veprimeve të kundërligjshme mund të jenë edhe qytetarët e thjeshtë të cilët posedojnë të drejtë e votes. Nën kërcënime, shantazhe, përdorim të forcës, shfytëzimin e armëve gjatë procesit zgjedhor ndikojnë tek vullneti i lirë i pjesëmarrjes në procesin zgjedhor. Ndër vite janë të njohura shumë raste ku janë prishur vendet e votimit nga persona me kërcënim të armës ose po kanë ndikur nëpërmjet shantazhit, por edhe premtimeve të kota në vullnetin e popullatës së gjërë.

Si persona zyrtar të cilët munden të jenë pjesëmarrës në parregullsit zgjedhore ose të cilët në mënyrë direkte e kryejnë një vepër të kundërligjshme zgjedhore janë antarët e Komisionit Shtetëror Zgjedhor, Komisionit Komunal dhe vetë Këshilli Zgjedhor. Për t'u zgjedhë anëtar i KSHZ-së duhet të jesh person i cili nuk i përket asnjë partie në shtet dhe nuk posedon asnjë preference politike. Por kjo mund të jetë e vërtet në teori, pasi në shtetin tonë ekzistojnë persona të cilët e kanë keqpërdorur këtë pozitë dhe kanë punuar për preferencat e njërës apo tjetrës parti .

Vendi ynë është i mbingarkuar nga skandalet e zbuluara me vones të parregullsive zgjedhore siç është rasti TITANIK i cili ishte edhe një ndër skandalet më të mëdha dhe i cili pasqyron kriminalitetin më të madh të personave zyrtar, pasi kjo vepër është kryer kryesisht nga persona me pozita të larta duke filluar nga vetë kryeministri i shtetit, ministrat, institucionet si ajo e policisë dhe gjykatave dhe në fund kryetarë të komunave, noterë dhe persona të tjerë.

KAPITULLI I KATËR

4. DËNIMET, SANKSIONET SIPAS KODIT PENAL

4.1. Dënimet që u shqiptohen kryerësve të veprave penale për vitet 2015-2021

Një proces zgjedhor përbëhet nga një procedurë e cila është e rregulluar dhe e mbrojtur me norma ligjore. Në vetë sjelljet ose veprimet e personave pjesëmarrës në zgjedhje të cilat janë të kundërligjshme bien në kundërshtim me ligjin, sjellin dëme të mëdha për shoqërinë dhe të njëjtat dënohen dhe sanksionohen. Por këto veprime të kundërligjshme sjellin edhe pakënaqësi në vetë popullatën e gjërë.

Për shkak të parregullsive, kërcënimeve dhe shantazheve të paraqitura në organet kompetente, vjedhjen e votatve disa vendvotime anulohen dhe shtyhen për ditë tjetër. Po ky anulim i votimit për një ditë tjetër sjell edhe disa faktorë me vete, si detyrimi i vet popullatës për të humbur kohën e vetë për ditë tjetër dhe për të dalë prapë për të votuar, shpenzime të mëdha të përsëritshme për mbajtjen e zgjedhjeve në ato pika të cilat shpenzime për riorganizimin e zgjedhjeve paguhen nga buxheti i mbledhur nga taksat e njerëzve.

Premtimet të cilat vijnë nga partit e ndryshme kanë euforinë në ato momente dhe me shtyrjen e votimeve detyrojnë edhe vetë partitë që të punojnë për të mbajtur frymën dhe euforinë e fitores. Normal se këto sjellje negative përbajnë në vete edhe dicka pozitive se njeriu kur mendohet dhe reflektohet edhe më gjatë ndryshon, por kjo nuk vlen për personat të cilët duan të fitojnë. Ndonjëherë vetë kandidatët e zgjedhjeve shohin dhe punojnë për grumbullimin e shumëvotave, por jo të punojnë për vullnetin e atyre personave. Ekzistojnë persona të cilët edhe pse kandidohen për ndonjë pozitë në zgjedhje ato nuk përbajnë aftësinë për të udhëhequr dëshirën e popullatës edhe pse ia arrijnë qëllimit dhe në fund punojnë për interesat e vetë partisë d.m.th të një ose dy personave.

Kjo punë e tyre në të shumtën e rasteve dënimin e merr nga vetë popullata e thjeshtë dhe nuk voton për personin X, por kjo pastaj sjell edhe pakënaqësi të shumta tek popullata të cilën e manifeston me mosdaljen në zgjedhjet paraprake, mos arritjen e shumicës për realizimin e zgjedhje dhe prapë kthehem në atë e cila do të thotë përsëritjen e zgjedhje dhe sjelljen deri tek harxhimii të mira materiale të mëdha për shtetin, pra dëme në kurriz të qytetarëve.

Dëm shumë i madh i cili reflekton nga kryerja e veprave penale gjatë zgjedhje i cili përfundon me anulimin e tyre. Shtyerja e zgjedhjeve ndikon negativisht në punën dhe marrjen e disa vendimeve të rëndësishme të cilat organet shtetërore kanë afat kohe të përcaktuar për t'i sjellë. Këto organe mund të jenë të institucioneve shtetërore, por edhe komunale. Vetë anulimi i disa proceseve dhe realizimi i detyrave nga ana e këtyre institucioneve sjellin dëme të mëdha për popullatën e gjere.

Veprimet e kundërlishme dënohen nga organet e drejtësisë të cilët mbas zgjedhjeve në bashkëpunim me Ministrin e Punëve të Brendshme mundohen të sqarojnë rastet e paraqitura dhe me atë t'u shqiptohen sanksionet kompetente për rastet në fjalë.

4.2. Disa raste të veprave penale dhe dënimet e shqiptuara kryerësve të këtyre vepra penale të viteve 2015-2021

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut si kapitull në vete të veprave penale kundër zgjedhjeve përfshin: **1)** Pengimi i zgjedhjeve dhe i votimit, **2)** Shkelja e së drejtës zgjedhore, **3)** Shkelja e lirisë së përcaktimit të zgjedhësve, **4)** Keqpërdorimi i së drejtës zgjedhore, **5)** Korrupsioni gjatë zgjedhjeve dhe votimi, **6)** Cënimi i fshehtësisë së votimit, **7)** Shkatërrimi i dokumenteve Zgjedhore, **8)** Mashtrimi zgjedhor, **9)** Keqpërdorimi i mjeteve për financimin e fushatës zgjedhore. Cilido që i kryhen këto vepra penale i shqiptohet sanksione ose dënime dhe atë prej 3 deri në 5 vjet burg.

Pengimi i zgjedhjeve dhe votimit (neni 158) përmban me vetë ruajtjen e së drejtës pjesëmarrëse të barabartë në ditën e zgjedhjeve. Ky nen parandalon përdorimin e forces, dhumes psikike ose fizike, kërcënime, shantazhe për mosmbajtjen e zgjedhjeve ose mosparaqitjen e rezultateve të votimit. Ky veprim dënohet më së paku me 3 (tre) vjet burgim. Nëse personi kryen këtë vepër penale me përdorim të armës atëherë dënohet edhe deri në pesë (5) vjet burgim.

E drejta e votës është e barabartë e secilit qytetar që përmbush moshën madhore, por nëse dikujt i cënohet kjo e drejtë atëherë ajo dënohet me nenin **Shkelja e të drejtës zgjedhore (neni 159)** e cila vepër penale më së shumti kryhet nga ndonjë anëtar i këshillit zgjedhor i cili duke shfytëzuar pozicionin e tij mund t'ia cënojë ndokujt të drejtën e votës.

Mundet t`ia pamundësojë votimin ose nuk do ta regjistrojë votën e tij. Ky veprim dënohet me së paku tre(3)vjet burgim. Poashtu nëse ndonjë anëtar i këshillit zgjedhor i mundëson ndonjë personi të votojë, por ai nuk ka të drejtë të votojë do të dënohet me tre(3)vjet burg.

Një qytetar që posedon te drejtën e votës ka të drejtë që të vendos se si do ta shfrytëzojë. Nëse ai vendos a dëshiron apo jo të votojë dhe për cilin dëshiron të votojë është e zgjedhje e atij. Cilido që mundohet t`ia çënojë këtë të drejtë, denohet me veprën penale **Shkelja e lirisë së përcaktimit të zgjedhësve(neni160)**. Kjo vepër penale dënohet me tre(3)vjet burg, por nëse kryhet nga ndonjë person zyrtar dënohet deri në pesë (5) vjet burg. Gjithashtu edhe nëse tentohet të kryhet kjo vepër penale ka dënimet e veta.

Evidencat shtetërore përmbajnë të dhëant e personave të cilat gëzojnë të drejtën e votës së lirë. Çdo person duhet të votojë vetë personalisht. Nëse dikush tenton të votojë në vend të dikujt tjetër, ose nëse dikush tenton të votojë më shumë se njëherë kryen veprën penale **Keqpërdorimi i të drejtës zgjedhore(neni161)** e cila dënohet me 3 vjet burg.

Ne rastet kur kemi të bëjmë me ofrim ose premtim të një shume me vlerë monetare në këmbim të votës të cilën i urdhërohet ta kryejë, mos e kryejë ose të votojë për një person konkret, kemi vepër penale **Korrupsioni gjatë zgjedhjeve dhe votimit(neni162)** i cili dënohet më së paku pese(5) vjetë burgim. Nëse personi i cili kërkon vetë që të shpërblehet për votën e tij atëherë ai dënohet me gjobë.

Cënimi i fshehtësisë së votimit(neni 163) mbron ne mënyrë të drejtpërdrejt të drejtën e zgjedhjes se për cilin dëshiron të votojë. Vota është e fshehtë dhe nëse dikush kërkon me shantazh që të marrë vesh se për cilin është votu ka të bëjë po me këtë vepër penale e cila dënohet më së paku tre(3) vjet burgim. Kjo vepër mund të kryhet edhe nga persona zyrtar ose anëtar të keshillit zgjedhor dhe dënohet me pesë(5)vjet burgim.

Dokumentet zgjedhore mbrohen dhe vëndohen në përdorim nga anëtarët e Këshillit Zgjedhor, por ndodhin raste kur ato mund të dëmtohen, shkatërrohen, përmirësohe dhe sjellin deri tek gjendja e mospërdorimit të tyre. Këto vepra penale dënohen në **nenin 164 Shkatërrimi i dokumenteve Zgjedhore** në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Të tilla vepra dënohem me tre(3)vjet burgim. Nëse kryhen nga personat zyrtar deri në pesë (5) vjet burgim.

Mashtrimi zgjedhor (neni165) është vepër penale e cila kryhet nga anëtarët e këshillit zgjedhor dhe atë duke marrë fleta votimi, plotësimin e tyre sipas dëshirës së vetë dhe

pastaj pasi numërohen votata kjo veprim ndikon në rezultatin kryesor përfundimtar. Kjo veprë penale dënohet me së paku pese(5) vjet burgim.

Një ndër veprat më të pranishme gjatë zgjedhje është edhe **Keqpërdorimi i mjeteve për financimin e fushatës zgjedhore(neni165-a)** i cili është shumë i pranishëm. Partitë politike për të realizuar fushatën e tyre zgjedhore e cila në të shumtën e rasteve është shumë e kushtueshme duhet të kenë mjete financiare të cilat në të shumtën e rasteve edhe nuk e paraqesin burimin prej ku i marrin këto të mira. Mosparaqitja e të ardhurave financiare, tejkalimi i shumës së caktuar me ligj, paraqet veprë penale e cila dënohet me gjobë ose më së paku me pesë (5) vjet burgim.

Shqiptimi obligativ i dënimit ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës neni(165-b). Për veprat penale nga nenent 158 deri ne 165-a të këtij kodi, gjyqi do t'i shqiptojë kryerësit ndalim për të kryerë profesion, veprimtari apo detyrë nën kushtet nga neni38-b nga ky kod Mospagesa e dënimit me gjobë³⁶

4.3. Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve

4.3.1 Mashtrimi

Nëse shohim në kontekstin zgjedhor, keqpërdorimi i pozitës zyrtare nënkupton shfrytëzimin e pozitës së një nënpunësi zyrtar për qëllime zgjedhore. Kjo është e sqaruar në mënyrë më të detajuar në kapitullin 16-Vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit. Ushtimi ose tentimi i presionit psikik ndaj të punësuarëve në administratë shtetërore publike ose në institucione tjera të cilat financohen nga buxheti i shtetit, buxheti komunal, si dhe shoqatat tregtare dhe ndërmarrëjet me kapital shtetëror.

Kërcënimet dhe shantazhet ndaj të punësuarëve mund të përshkruhen si kërcënim të heqjes nga puna shtetërore ose ulja e rrogës dhe beneficioneve tjera nëse ky i punësuar nuk mbështet partinë të cilën i kërkohet. Në një farë mënyre kjo formë e mashtrimit mundet të merret edhe si shtypje psigjike e cila vijon me kërcënime dhe ndikojnë dukshëm në psiqikën

³⁶Doc.Dr.Afrim Osmani, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, faqe 151,152,153,154,155,Shkup 2010

e një personi të punësuar i cili më pas kryen veprimet e kundërligjshme që sjellin vepra penale kundër zgjedhjeve.

4.3.2 Dhenia/Marrja rryshfet

Nëse flasim për korrupsionin në një shtet duhet të flasim për marrjen dhe dhënien e rryshfetit. Personat zyrtarë të cilët marrin një vlerë parash për ta kryer një punë të cilën ai është i obliguar ta kryejë si i punësuar në atë sektor pa marrë vlerë monetare ai quhet i korruptuar. Marrja ose dhënie e parasë në këtë rast paraqet një veprimtari e cila është në kundërshtim me ligjin. Pra, me korrupsion nënkuptojmë çdo shfrytëzim të funksionit, të autorizimit zyrtar, detyrës dhe pozitës zyrtare, me qëllim të arritjes së përfitimit të kundërligjshëm për veten apo për tjetrin.³⁷

Marrja e rryshfetit është një veprimtari e definuar si vepër penale edhe në Kodin Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 357 i cili përkufizon definicionet e marrjes së rryshfetit. Nëse një person zyrtar kërkon ose pranon vlerë monetare ose ndonjë dhuratë apo dobi tjetër me qëllim që në suancat e veta të autorizuar kryen ose nuk do të kryej ndonjë veprim zyrtar do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet. Dhurata apo dobia pasurore do të meret nga autoritetet e caktuara.³⁸

Dhënia e rryshfetit është vepër penale e cila gjithashtu dënohet dhe atë në bazë të nenit 358 të Kodit Penal dhe atë personi i cili i ofron të mira materiale një personi zyrtar vetë që ky të kryej ose jo ndonjë punë në suanzat e punës së tij zyrtare. Kjo denohet deri në pesë vjet burgim³⁹. Dhënia e rryshfetit bëhet më së shumti nga personat e thjeshtë të cilët pasi kanë kryer ndonjë kërkesë për ndonjë shërbim publik, e njëjta vonon për një kohë shumë të gjatë dhe si rezultat i asaj për ta marrë sa më shpejt këtë shërbim publik legjitim ato ofrojnë dhënie të rryshfetit.

³⁷Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Gazeta zyrtare e RM-së, Janar 2019, nr.12, faqe 25, neni 2, paragrafi 1

³⁸Neni 357, KPM

³⁹Neni 358, KPM

4.3.3 Përdorimi i dhunës dhe kërcënimeve

Gjatë një procesi zgjedhor ndodhin shumë veprimtari të cilat bien në ndeshje me vetë ligjin dhe si të atilla dënohen. Por, që të raportohen në institucionet përkatëse duhet të ekzistojnë prova që dëshmojnë se me të vertetë ekziston një sjellje e kundërligjshme.

Përdorimi i kërcënimeve të njëpasnjëshme ndaj votuesve është shumë i pranishëm në shtetin tonë. Kemi persona të cilët punojnë në punë zyrtare dhe u kërcënohen punonjësve të tyre se nëse ato nuk votojnë për personin që ato kërkojnë do të përzihen nga puna, pra kemi të bëjmë me kërcënim në vendin e punës. Kjo dhunë nënkuptohet edhe si dhunë institucionale ose kolektive ku kemi nderhyrje ose veprim i organeve të pushtetit në faza të caktuara të procesit zgjedhor.⁴⁰ Kemi kërcënime ndaj personave të thjeshtë të cilëve u është dhënë ndonjë vlerë monetare dhe në këmbim të asaj votën e tyre por ky i fundit kundërshton që ta mbush premtimin e tij.

Nëse personat të cilët tashmë kanë përdorur kërcënimin gjatë procesit zgjedhor nuk ia kanë aritur qëllimit atëherë ato përdorin forcën dhe ushtrojnë dhunë. Ushtrimi i dhunës është një veper penale shumë e rëndë, por i njëjti duhet të kallëzohet në institucionet e punëve të brendshme, nëse jo atëherë nuk ekziston mundësia për zbulimin e njëjtë.

Raportimi i përdorimit të dhunës dhe kërcënimit ndihmon shumë që organet përkatëse të bëjnë zbulimin e autorëve dhe të parandalojnë për vazhdimin e tyre ndaj personave të njëjtë, por edhe ndaj personave të tjerë.

4.3.4 Mosraportimi ose raportimi i rreme i informacioneve zyrtare

Komisioni zgjedhor ka për detyrë kryesore mbajtjen e zgjedhjeve korekte, të barabarta, demokratike, por edhe të paraqesin raport të saktë dhe të vërtet. Sesionet e KSHZ-së kanë qënë të hapura për mediat dhe për qytetarët e interesuar ku në disa raste edhe kanë qënë të lëshuara direkt në kanalën shtetëror, por në përjashtim të disa raste kur kanë qënë të mbyllura. Në çdo përfundim të mbajtjes së një procesi zgjedhor edhe në rastet kur bëhet anulimi i asaj raporti i shkruar nga anëtarët e Këshillit Zgjedhor, i njëjti i cili është publikuar në afat të përcaktuar ligjor mbrenda 48 orëve, sipas rekomandimit paraprak të

⁴⁰Dr.Mahi Nesimi, Doracak terminologjik për zgjedhje, faqe 19, tetovë 2020

OSBE/ODIHR-it. Çdo shkelje e së drejtës së votës, çdo parregullsi, çdo dëm të materialit zgjedhor duhet të jenë të përshkruara në mënyre korrekte.

Mosraportimi i informacioneve zyrtare çon në dëm të gjithë procesin zgjedhor i cili më pas duhet të përsëritet dhe të detyrojë popullatën të dalë përsëri në zgjedhje, të harxhojë të mira financiare dhe shumë punë të tjera të cilat vetëm përsëriten në dëm të qytetarit. Nëse tashmë ka arritur ndonjë ankesë në Komisioni Komunal të Zgjedhjeve, i njëjti është i detyruar të lëshojë formular ankese për secilin votues që i drejtohet KKZ-së me qëllim të paraqitjes së ankesës, ose ta udhëzojë dhe ta ndihmuar të plotësojë formularin elektronik për parashtrimin e ankesës në www.prigovori.sec.mk⁴¹

Nëse raportohen informacione të rreme zyrtare ato atëherë bëjnë kollaps në sistemin e drejtësisë. Nëse një informacion i rremë merret për i saktë atëherë ne kemi të bëjmë me vepër penale kundër shtetit. Nxjerr fitimtar dikë i cili nuk ka fituar dhe humbës dikë që ka fituar. Drejtësia nuk mund të fitojë dhe gjithçka vëndohet në një pikëpyetje e madhe. Nëse drejtësia në një shtet vihet në një pikëpyetje atëherë edhe siguria dhe stabiliteti i një shteti është i rrezikuar.⁴²

4.3.5 Mjetet për zbatimin e zgjedhjeve

Nje proces zgjedhor ka fazat e tij të cilat duhet të respektohen në përpikëshmëri. Pasi caktohet data e zgjedhjeve organet ose Komisioni Zgjedhor fillon punën e tij. Komisioni zgjedhor përbëhet nga kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e tij. Duke u bazuar në ligjin dhe kodin e mbajtjes së zgjedhjeve komisioni fillon përgatitjet e tij. Në një periudhë kohe të caktuar Komisioni Zgjedhor zgjedh anëtarët e tij dhe zëvendësuesit e tyre me qëllim që të fillojë përgatitjen e tyre. Mbahen seanca të shumta në përpilimin e formave dhe rregullave se si mbahet një proces zgjedhor por edhe në futjen e risive të cilat me kalimin e kohës i pranon Kuvendi dhe i voton të njëjtat.

Si mjete për mbajtjen e një proces zgjedhor merren vetë materialet që tashmë janë të përcaktuara dhe të mbrojtuar para ditës së zgjedhjeve të cilët mbajnë listë e verifikimit të votuesve, lista e votimeve dhe materiale të tjera të caktuara me ligj.

Një proces gjyqësor përfshihet nga: **-lista e votuesve** e cila përmban të dhënat personale të votuesve që gëzojnë të drejtë e votës, të dhënat të marra nga të dhënat amë,-

⁴¹www.prigovori.sec.mk

⁴²Прирачник за млади гласачи

Kontrolloni me llambë UV është një procedurë më anë të së cilës mund të vërtetohet nëse votuesi ka votuar tjetër herë, **-Verifikimi i dokumenteve të identifikimit personal** – cili kryhet duke e vërtetuar nëpërmjet letrës së njoftimit ose pasaportës së vlefshme, - **Kontrollimi dhe nënshkrimi në listën e votuesve, -Lëshimi i fletës së votimit, pra një personi i jepet një fletvotimi, -Spërkatja e votuesit/es me UV sprej, -Votimi mbrapa paravanëve të votimit, votohet në mënyrë të fshehtë, -Vendosja e fletëve të votimit në kutinë e votimit**

4.4 Sanksionet me të cilat janë dënuar kryesit e veprave penale gjatë viteve 2015-2021

Organet të cilat mbrojnë të drejtën e qytetarit gjatë krejt procesit zgjedhor, prej paraqitjes së listave zgjedhore, koha parazgjedhore dhe deri në mbajtjen e zgjedhjeve, shpalljen fituesve janë policia e shtetit dhe Gjykata. Në çdo parregullsi që ndodh në këto ditë këto janë dy organet të cilat duke vepruar me ligj mbrojnë, por edhe dënojnë veprimet e qytetarëve.

- Në vijim do të paraqesim një vendim gjyqësor i shqiptuar në Gjykatën Themelore të Gostivarit e cila nuk ka ndodhur në periudhën e viteve 2015-2021, por vendimi është shqiptuar po në këtë periudhë, lidhur me kryerjen e veprës penale neni 158- **Pengimi i zgjedhjeve dhe i votimit:**

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Gjykata Themelore në Gostivar, kryesuar nga gjyqtarja V.N si presidente e këshillit, gjyqtarja M.A dhe gjyqtarët e tjerë ZH.L, K.P dhe Z.A si anëtarë të këshillit me procesmbajtjes A.K, duke vepruar sipas aktakuzës të Gjykatës Themelore Gostivar AP, nr.256/08 me 09.03.2009 kundër të akuzuarit A.M nga D., mbasi u mbajt seanca gjyqësore kryesore i cili filloi më vitin 17.09.2015 dhe vazhdoi deri më vitin 03.03.2016 në prezencë të prokurorit publik në Gjykatë GJ.H, të akuzuarit A.M si dhe advokatit mbrojtës të dëmtuarit, advokatja T.A nga G., më ditën 03.03.2016, e solli dhe e publikoi vendimin:

VERIDIKTIN

Të paditurit:

A.M. nga babi GJ_____ nëna A_____ i lindur më vitin në D. Ku edhe jeton në rr..... me nr..... me kombësi shqiptare, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me shkollë fillore, i papunësuar, pa pasuri, i martuar me fëmijë minor, ushtrinë të pakryer, i paakuzuar më parë dhe nuk ka akuzë tjetër përmbi veten i vërtetuar me letër njoftimi dhe numrin amzës

AKUZA HIDHET POSHT

Sipas nenit.367, parag.1 ngs Kodi Penal

Për arsye se:

Me datën 01.06.2008 në orën 14 në vendvotimin nr..... në Zonën e Gjashtë në Fsh..... D.... gjatë mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare më vitin 2008 në Republikën e Maqedonisë, i akuzuari A.M bashkë me të akuzuarit K.S dhe A.D të organizuar, me përdorimin e dhunës shkaktuan mosmbajtjen e zgjedhjeve në atë mënyrë që hyn në vendin ku janë mbajtur zgjedhjet në shkollën fillore në fsh.A, gjatë kohës së mbajtjes së zgjedhjeve në praninë e anëtarëve të komisionit zgjedhor kanë grisur 20 fleta votimi, i kanë mbushur duke rethuar numrin 6, kanë vendosur peqatin nga të dyja anët, dhe më pas i kanë vendosur në kutin.

Me këtë veprim i akuzuari A.M ka kryer veprë penale të nenit 158 -**Pengimi i zgjedhjeve dhe votimit** i Kodit Penal, përfaqësuesi i të akuzuarit hoqi dorë nga akuza në fjalën e tij përfundimtare Sipas nenit.93 parag.1 nga Kodi Penal, hargjimet e procesi gjyqësor bien mbi buxhetin e gjyqit.

ARSYETIM

Prokurori publik nga Gostivari i ka dorëzuar gjykatës aktakuzë Ap, nr.256/08 i vitit 09.03.2009, kundër të akuzuarit e lartpërmëtur K.S, A.D dhe A.M të gjithë nga fshati D. Për veprën penale Pengimi i zgjedhjeve dhe votimit neni 158, parag. 2.

Kjo gjykatë, duke u bazuar ne këtë lëndë më datën 17.10.2011 ka sjellë vendim me të cilin të akuzuarit SH.K., E.N, E.L, F.S dhe Y.V për veprë penale falsifikimnë një vijë të drejtë. I dënuari K.S u dënua me 3 vjet burg, ndërsa të akuzuarve të tjerë u është shqiptuar dënim me 1 vjet, por në të njëjtën kohë u është shqiptuar se nëse nuk kryejnë ndonjë veprë penale tjetër mbrenda 3 muajve nuk do të mbahet nga të njëjtit.

Pasi kthehet prap lënda për të akuzuarin A.M para shkallës së parë në rishqyrtim me çka do të shënohet me K.nr.594/12

Pas rishqyrtimit të lëndës, pasi i rishqyrtuan të dhënat, mbajtjes së fjalës së fundit të prokurorit publik është vërtetuar se personi A.M nuk ka qënë prezent dhe vetë dëshmitarët e asaj dite kanë konfirmuar të njëjtën si dhe të gjithë dëshmitë vërtetojnë të njëjtë, për këtë arsye vërtetohet se personi i akuzuar nuk e ka kryer veprën penale dhe aktakuza hidhet posht.

Mbas seancës së fundit prokurori publik u tërhoq nga aktakuza dhe personi i akuzuar nuk dënohet. Të gjitha harxhimet gjyqësore mbeten në buxhetin e gjykatës themelore.

Gjykata themelore Gostivar Ap,nr.594/12 më vitin 03.03.2016

Procesmbajtës Gjykatësi

A.K

V.N

Në mbajtjen e zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, parim kryesor është mbajtja e zgjedhjeve të lira dhe demokratike dhe pasqyrimi i shprehjes së lirë dhe të barabartë të pjesëmarrësve të këtyre zgjedhjeve.

Nëse bazohemi në këtë lëndë e marë nga Gjykata e Gostivarit, do të hasim në pasqyrimin e një rasti i cili na jep një rast ku pengohet mbajtja e zgjedhjeve. Personat të cilët kanë dashur të votojnë në ose konkretisht ato kanë dashur vetëm të bëjnë rëmuje dhe të pengojnë votimin. Ato kanë përdorë forcën e cila repsisht dënohet edhe me ligj duke cënuar edhe jetën e antarëve pjesëmarrës në procesin zgjedhor, duke marrë fleta të votimit të cilat nuk iu përkasin atyre dhe i mbushur në mënyrëkundërligjore duke u bazuar në ligjin e shkruar “një qytetar-një votë”, gjë të cilën ato nuk e kanë respektuar.

Personat e organizuar për të krijuar kaos në vendin e votimit, janë persona të cilët më pas janë gjykuar nga gjyqtarët të bazuar sipas ligjit, por ndoshta edhe vetë ligji përmban ato zbrazëtirat të cilat këtyre personave në të vërtetë vetëmiu hiqet vërejtje se nëse ndodh edhe njëherë në një periudhë kohe të caktuar do të gjykohen nëse jo atëherë janë të lirë gjithmonë duke u bazuar në suazat e ligjit.

Edhe pse këto persona tentojnë të prishin rrjedhojën e zgjedhjeve gjë të cilën ndoshta edhe e kanë arritur, procesi zgjedhor mundet të përsëritet në këtë vendvotimi dhe të dhënat të merren për të plotësuar zgjedhjet.

- Një tjetër veprë penale e cila ka ndodhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut e cila ka ndodhur në Kumanovë, lidhur me kryerjen e veprës penale- **Cënimi i fshehtësisë së Votimi:**

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Gjykata Themelore në Kumanovë, kryesuar nga gjyqtarja S.GJ si gjyqtar kryesor, gjyqtari M.S dhe gjyqtarët e tjerë O.G, T.M dhe S.D si anëtarë të këshillit me procesmbajtjes V.A, duke vepruar sipas aktakuzës kundër të akuzuarit A.S nga K....., i akuzuar me aktakuzë në Prokuror Publik në K....., Ap, nr..... viti 26.06.2013, ka kryer veprë penale Cënimi i fshehtësisë së Votimit i nen.163, parag 1 i Kodit Penal, në seancën e mbajtur me pjesëmarrjen e prokurorit publik në Gjykatën Themelore Kumanovë B.R, i akuzuari A.S mbrojtësi i të akuzuarit B.S., më vitin 05.07.2013, e sjell vendimin:

VERIDIKTI

I AKUZUARI : A.S. nga babai Q. Dhe nëna Y., i lindur më..... viti... në K.... ku edhe jeton në Rr....., shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i punësuar në Agencijonin SH.S., me pagesë mujore prej 15.000 denarë, pasuri të mesme, i martuar, me shkollë të mesme, nuk ka qënë asnjëherë i dënuar, nuk ndiqet penalisht për ndonjë veprë tjetër penale.....

FAJTOR

Për arsye se:

Më datë 07.04.2013 rreth orës 17:30, në vendvotim nr....., në vendin R.U. PM në K... gjatë kohës së votimit e cënuar fshehtësinë e të votuarit dhe atë në mënyrën kur pasi ka votuar, në këtë vendvotim pas tij ka hyrë nëna e tij Y.S., e cila gjithashtu e ka kryer të drejtën e votës, por në momentin që është dashur që të rrethojë numrin që ka dëshiruar i akuzuari A. i cili ka qënë tek dera ka bërë titur në gjuhën shqipe “rrethoe numrin 42”, me çka presidenti i komisionit M.B i ja ka tërhequr vëmendjen se ai nuk mundet të sillet në atë mënyrë me ligj, ai i është drejtuar me fjalët “Ti ulu aty, dhe mos u përzi, nuk është puna jote”

Me këtë veprim i akuzuari A.S nga K... ka kryervepër penale **Cënimi i fshehtësisë së Votimi** neni 163, parag.1 i Kodit Penal, dhe me nenet 32, 33, 35, 39, 40 dhe 41 nga Kodi Penal gjyqi i shqipton:

DËNIM ME BURG 1- NJË VJET

Sipas zbatimit të dispozitave të nen.48, 48-a parag.1, 49 parag.1 dhe neni 50 parag.1 dhe 3 i Kodit Penal, gjyqi në të njëjtën kohë i shqiptonën edhe një **DËNIM ALTERNATIV:**

DËNIMI I SHQIPTUAR PREJ 1 –NJË VJET, nuk do të mbahet nëse i akuzuari A.S, në afat prej 3-TRE VJETËVE, mbas shqiptimit të dënimit nuk do të kryejë veprë të re penale.

TË PAGOJË gjykatës një shumë me vlerë 3.000 denarë, në afat kohe prej 15 ditësh nga hyrja në fuqi të vendimit gjykues.

KËSHILLA: kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa pasi që i akuzuari heq dorë nga ankesa kundër vendimit të shqiptuar, prandaj ky vendim hyn në fuqi prej ditës që është shqiptuar.

Procesmbajtëse:
gjykatësi

V.A

Kryet. I këshillit-

S.GJ.

Në rastin e përshkruar më lartë kemi të bëjmë me rast i cili ka ndodhur në Kumanovë ku personi i përmendur nuk ka respektuar të drejtën e fshehtësisë gjatë votimit. Në përcaktimin e neneve të Koditit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut rol shumë të rëndësishëm është përcaktimi i nenit të fshehtësisë së votimit. Kjo ndërthur në vete edhe shprehjen e lirë të një qytetari, por duke e mbajtur të fshehtë për popullatën e gjërë në vetë aspektin se ndihesh më i sigurtë dhe nuk duhet të arsyetohesh në pikëpamjen personale politike.

Respektimi i fshehtësisë së votimit mban në vete edhe një shpresë se qytetarët do votojnë për atë të cilët ato e mendojnë të duhurin dhe shprehin dëshirën personale, ndërsa nga ana tjetër nëse dikush ju cënon në këtë të drejtë atëherë vetëm voton për të plotësuar dëshirën e dikujt tjetër si në rastin konkret.

Në historin e zgjedhjeve në shtetin tonë kemi pasur votime familjare të cilat janë dhe kanë qënë të ndaluara dhe dënohen me ligj, por në atë kohë kanë qënë më të përhapura gjë që në ditët e sotshme nuk i gjejmë ose po nuk ekspozohen si përpara por ende ekzistojnë.

PËRFUNDIM

Zgjedhjet e lira, të barabarta janë gurthemeli i një besimi në demokracinë e një shteti, janë baza e mbrojtjes së shprehjes të lirë të njerëzve dhe veprimeve e mosveprimeve të tyre. Nëse çënohet e drejta e barabartë atëherë kemi të bëjmë me veprimet e kundërligjshme. Demokracia e një shteti krijon ligje të cilat janë në favor të popullatës së vet dhe të vetë shtetit.

Në ndërtimin e një demokracie në një shtet, ligji mban bazën kryesore shtyllën dhe të gjithë drejtohen kah ligji i cili buron ose e formon Kodin Penal i cili rrjedh nga Kushtetuta e shtetit. Në këtë punim ne i trajtuan ligjet e zgjedhjeve pra bazohemi nga Kodi Zgjedhor, mënyra e aplikimit, gjegjësisht si funksionojnë instrumente të caktuara specifike në praktik. Në momentin që vendosim ose e respektojmë ligjin atëherë ne mbrojmë të drejtën e votës së lirë e cila edhe është edhe baza e zgjedhjeve të lira dhe demokratike.

Nëse nuk respektohen ligjet atëherë kemi të bëjmë me veprime kundërligjore të cilat pastaj sjellin edhe pasojat e veta. Këto veprime kanë pasojat e veta të cilat ndikojnë në shoqërinë. Zgjedhjet demokratike mbrojnë edhe popullatën edhe ligjin, ato ndihmojnë në krijimin e një hierarkie që do të jetë e favorshme për të dyja palët. Në këtë punim i trajtuam po këto sjellje të kundërligjshme, por në kohën para, gjatë dhe pas mbajtjes së procesit zgjedhor.

Procesi zgjedhor është procedurë që ka kohën e kufizuar gjatë mbajtjes së saj, por që konsiston në marrjen e vendimeve të mëdha, me kohëzgjatje teje të zgjatur dhe me pasoja të mëdha për shoqërinë. Gjatë procesit zgjedhor i cili mbahet në korniza të kufizuara dhe të rregulluara me ligj, kryhen edhe veprime të ndaluara mbrenda këtyre kornizave.

Veprat penale gjatë procesit zgjedhor munden të jenë të kryera nga subjektet e thjeshta por edhe nga persona zyrtar. Subjektë të thjeshtë kanë të bëjnë me persona të cilëve u mundësohet pjesëmarrja në procesin zgjedhor si votuesit e barabartë ashtu edhe personat të cilët ligji ua mundëson që të jenë pjesëmarrës në një proces zgjedhor. Persona zyrtarë janë personat të autorizuar nga sistemi shtetëror në mbajtjen e një procesi zgjedhor, të lidhur shumë ngusht me ligjin, janë persona që e vendosin ligjin në vend, të arsimuar dhe të punësuar në institucione të larta.

Detyra zyrtare e tyre është e përkufizuar me ligj dhe ato kryhejnë punë në interes të të mirës së popullit. Në rastete kur nuk e drejtojnë punën e tyre në përëputhje me ligjin por

fokusohen në interes privat dhe personal për përfitime të ndryshme bien ndesh me betimin e tyre në ligj. Personat zyrtarë të cilët janë të punësuar në pushtetin lokal dhe qëndror meren me keqpërdorime në këtë sferë e cila edhe ua mundëson qasjen në informacione sekrete të cilat vetën për shkak të punës kanë këtë mundësi.

Në këtë punim do të trajtohen veprat penale veç e veç të kryera gjatë kësaj kohe, evidencat statistikore të marra nga organe shtetërore si dhe organizatat joqeveritare. Për parandalimin e këtij fenomeni duhet të ketë një bashkëpunim më të ngushtë me policinë, prokurorinë publike dhe gjykatat, një hetim më të detajshëm të ligjit të veprave penale e cila është e theksuar qart në Kodin Penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në trajtuam ligjet e Kodit Zgjedhor baza e vet zgjedhjeve të lira dhe demokratike por respektimi dhe mosrespektimi i tyre në praktikë vëndon në përdorim edhe instrumentet e mbrojtjes së ligjit instrumentet shtetërore, si: gjykata, policia dhe sanksionet shtetërore. Momenti i cënimit se drejtës së votimit rezulton në një veprim të kundërligjshëm i cili më pas jep detyrë sanksioneve penale të dënojnë po ato veprime prej të cilave ligji çënohet. Nëse çënohet ligji nga veprimet e personave si të thjeshtë edhe zyrtarë është e domozdoshme që të njëjtëve t'u shqiptohen sanksione përkatëse sepse nëse nuk ka besim në ligj, lëkundet edhe vetë demokracia e një shteti e cila është edhe fundamenti kryesor në hecjen e një shteti të lirë dhe të besueshëm për popullatën e gjërë.

BIBLIOGRAFIA

a) Libra:

1. Hyrje në Psikologji Politike, [Martha L. Cottam](#), Tiranë 2009.
2. Partite politike, zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore, Etem Aziri, Tetovë, 2015.
3. Sistemet politike, Etem Aziri, Univerziteti i Evropës Juglindore, ne Tetov, Shkup, 2012
4. Sociologjia e partive politike, Etem Aziri, Univerziteti i Evropës Juglindore, ne Tetov,2004
5. E drejta kushtetuese, Kurtesh Saliu, Prishtinë, 1998
6. E drejta Kushtetuese, Jeton Shasivari, Shkup, 2015
7. Voved vo pravo, Stefan Bugjakoski, Skopje, 2008
8. Përthyerjet Politike, Ismail Arslani, Tetovë, 2013
9. Partit Politike dhe demokracia, Etem Ayiri, Logos A, Shkup, 2004
10. Dhunimi i vullnetit : zgjedhjet parlamentare 2008, Mahi Nasimi,Tetovë, 2009.
11. Ndikimi i zgjedhjeve dhe sistemi zgjedhor në demokratizimin e sistemit politik të Republikës së Shqipërisë,Oreta Saliaj,Tetovë, 2014.
12. Komploti kundër lirisë: Shqipëria nga diktatura në demokracinë bollshevike, Andrea Stefani, Tiranë, 2011.
13. Politika, [Andrew Heywood](#), Tiranë, 2008.
14. Partia Demokratike shqiptare, Lindja zhvillimi dhe veprimtaria, Zeqirja Rexhepi,Tetovë 2004
15. Elezi, I. (2013), “E drejta penale” (Pjesa e posaçme), Botimet Erik, Tiranë
16. Doracak terminologjik për zgjedhje, Mahi Nesimi, 2020.
17. Hajdari, A. (2015), “ E drejta e procedurës penale”, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë.
18. Gruda, Z. (2000), “Mrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut I”, Prishtinë, 2000.
19. Joshua D. (1995), “Understanding criminal laë, Cecond edition, New York.
20. Kambovski.V, (2007), “E drejta penale pjesa e përgjithshme”, Shkup
21. Marijanov.GJ, (1998), “ E drejta penale pjesa e pergjithshme”, Shkup
22. Zejneli, I., E Drejta Penale, - Pjesa e posaçme, Tetove, 2007.
23. Salihu, I., E Drejta Penale – Pjesa e Posaçme, Prishtinë, 2014.
24. Marjanoviç,GJ, (2003), “E drejta penale”, pjesa e përgjithshme, Shkup.
25. Sahiti, E. & Murati, R., E Drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2016.

26. Sahiti, E. & Zejneli, I., E Drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Tetovë, 2007.
27. Demokracia dhe shteti i së drejtës, Xheyair Zaganjori, Tiranë, 2002
28. Izborno pravo i strancki sustav, Dieter Nohlen, Skolska Knjiga, Zagreb, 1992
29. Kushtetuta e Republikës Veriore të Maqedonisë
30. Ligji për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin Republikës së Maqedonisë
31. MIA- Makedonska Informativna Agencija, Shkup, Izbori
32. Makfaks – Shkup
33. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, stenogramet e Mbledhjes te viteve 2010-2021

b)Aktet ligjore:

1. Kodi (Ligji) Penal i Republikës Veriore të Maqedonisë;
2. Ligji për Zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës Veriore të Maqedonisë;
3. Gazeta Zyrtare e R.M
4. Граѓанска асоцијација МОСТ
5. Ligji për egzekutimin e sanksioneve penale
6. Ligji për Rendin dhe Qetësinë Publike;

b) Burime tjera:

34. Граѓанска асоцијација мост
35. <http://www.sec.mk>